



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:
"Shkenca Informatike" me profile: "Informatikë Biznesi", "Teknologji
Informacioni", "E-Commerce dhe Inovacion"
ofruar nga
Kolegji Universitar "I Biznesit"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Ana KTONA 

Prof. Asoc. Evis TRANDAFILI 

Shtator / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”,
“Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “I Biznesit”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile: “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr.340, datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	8 PAE / 3 PAK (Viti akademik 2022-2023)
18	Numri i studentëve:	2021-2022 - 16 studentë; 2022-2023 - 17 studentë.
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar i Biznesit, (KUB) është një Institucion jopublik i Arsimit të Lartë liçencuar me VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 me emërtimin Akademia Profesionale e Biznesit, (APB). APB është riorganizuar me Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 361, datë 23.12.2020 dhe është riakredituar për herë të fundit me vendim BA Nr. 03, datë 07.01.2022 me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri me 06/01/2026.

KUB përbëhet nga 3 njësi kryesore:

1. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike
2. Fakulteti i Ekonomisë
3. Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale

Fakulteti i Ekonomisë, njësi kryesore ku ky program studimi ofrohet, është i përbërë nga tre njësi bazë, përkatësisht:

1. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
2. Departamenti i Menaxhimit;
3. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës;

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” përfshihet në ciklin e dytë të studimeve universitare dhe ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës, Fakulteti i Ekonomisë, Kolegji Universitar i Biznesit, hapur me urdhër MASR Nr. 340, datë 17.09.2021, “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me tre profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” në Kolegjin Universitar të Biznesit”. Aktualisht, KUB është në proces riorganizimi sipas shkresës së MAS Nr. 959 dhe vendimit të Senatit Akademik të KUB, Nr. 2, datë 15.02.2024 për riorganizimin e dy njësive kryesore në një njësi të vetme dhe për hapjen e njësive kryesore “Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike”. Sipas organigramës së propozuar, programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me tre profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” do të ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Aplikuar, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike, Kolegji Universitar i Biznesit. Vlerësimi i jashtëm për qëllim të akreditimit të programit të studimit po realizohet për herë të parë bazuar në kërkesën e Rektorit të KUB, drejtuar ASCAL-it, më datë 04.10.2022, Nr. 365/1. Programi i studimit ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe në përfundim të tij përfitohet Diplomë Universitare Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”. Programi i studimit është i hartuar dhe zbatohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës, duke harmonizuar të gjithë komponentët e tij në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe me qëllimet dhe misionin e Institucionit dhe Departamentit. Qëllimi i këtij programi studimi është: Të përgatisë specialistë të fushës së shkencave informatike në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm, për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion". Bazuar në Urdhër nr 148, datë 11.12.2023 për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit, aplikuar nga Kolegji Universitar i Biznesit", grupi i vlerësimit përbëhet nga:

– **Prof. Dr. Ana Ktona**

– **Prof. Asoc. Evis Trandafili.**

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Arbri Ndreka. Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Dhjetor 2023 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Kolegji Universitar i Biznesit (KUB) për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Kolegji Universitar i Biznesit, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB, dokumentacioni i paraqitur edhe në sistemin AMS të ASCAL. Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 15 dhe 16 Shkurt 2024, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Kolegjit Universitar të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit të procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterëve, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Më datë 24.07.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.14/3 Prot., datë 24.07.2024 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 16.08.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr.14/6 Prot., datë 16.08.2024, ka dërguar komente mbi draft raportin.

Përgjigje ndaj komenteve të Kolegjit Universitar të Biznesit në lidhje me vlerësimet e Grupit të Ekspertëve për

B. Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”

1. Në lidhje me Fushën 1 Standardi I.2 Kriteri 1

Përgjigje e GVJ:

Nga komenti i institucionit konstatohet që vlerësimi i GVJ pranohet nga institucioni. Kolegji Universitar i Biznesit është i ndërgjegjshëm për mungesën e stafit akademik me tituj dhe grada, dhe institucioni po bën përpjekje për rritjen e numrit të stafit akademik me grada shkencore. Vlerësimi i GVJ i referohet periudhës së implementimit të programit të studimit në bazë të dokumentacionit në dosje dhe vizitës në institucion. RVJ nuk ndryshon.

2. Në lidhje me Fushën 1 Standardi I.3 Kriteri 4

Përgjigje e GVJ:

GVJ vlerëson përfitimet institucionale nga aktivitetet kërkimore shkencore, por thekson rolin e rëndësishëm që luajnë marrëveshje me kompanitë për zhvillimin e praktikave profesionale në programet e studimit të fushës së Teknologjisë së Informacionit. Vëmë në dukje që në raportin vjetor të Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës nuk janë analizuar përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të përmbushjes së objektivave të Praktikave Profesionale. Roli dhe feedback-u i pedagogëve të caktuar me urdhër Dekani për ndjekjen e praktikave profesionale nuk është konsideruar në raport. Marrëveshjet e bashkëpunimit nuk janë kategorizuar në nivel programi studimi ose departamenti. Komenti i paraqitur nga institucioni nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon.

3. Në lidhje me Fushën 2 Standardi II.1

Përgjigje e GVJ:

(i) Puna e GVJ ka qënë objektive në analizën tërësore të të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe të ndërthurjes së informacionit në funksion të cilësisë në tërësi të procedurave dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni. Në këtë kuadër, GVJ mendon që përsëritja e

informacionit mund të bëhet burim inkonsistencash në rastet e përditësimit të njërës prej rregulloreve dhe sugjerimi nuk lidhet me ligjshmërinë. RVJ nuk ndryshon.

(ii) Në Rregulloren e programit të studimit, Neni 12. Citojmë: “ ... *Vlerësimi i vazhduar në masën 40% është I DETYRUESHËM, por në rastet e lëndëve aplikative, pedagogu ka të drejtë të organizojë një shpërndarje të ndryshme të peshës së elementëve të vlerësimit të vazhduar duke përcaktuar atë në syllabusin e lëndës.*”

Sqarojmë institucionin që GVJ nuk është shprehur në asnjë moment që Rregullorja e cituar më sipër bie ndesh me VKM 41, por mendojmë që kjo pjesë e rregullores krijon konfuzion në lidhje me detyrimin e vlerësimit të vazhduar 40% dhe lirisë akademike të pedagogut për një shpërndarje të ndryshme të vlerësimit të lëndëve aplikative. Sikurse sugjerohet edhe në vlerësimin përkatës të Standardit, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të përcaktojë grupin e lëndëve aplikative që përjashtohen nga kjo pikë e rregullores OSE ta konsiderojë në rregullore formën e vlerësimit të dijeve si pjesë e lirisë akademike të titullarit të lëndës dhe të përcaktohet në syllabuset e miratuara në fillim të çdo viti akademik. Komenti i paraqitur nga institucioni nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon.

(iii) Vlerësimi i ekspertëve për këtë pikë i referohet materialit të vënë në dispozicion të GVJ-së. Në hartimin e raportit të vlerësimit, grupi i ekspertëve është mbështetur në kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018, “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë” dhe VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë” dhe nuk gjykon në lidhje me procese të mëparshme të institucionit apo të programit të studimit.

GVJ thekson edhe njëherë rëndësinë e hartimit dhe zbatimit me korrektësi nga institucioni të planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve. Këto dokumenta të miratuar nga instancat më të larta të IAL duhet të jenë në harmoni me njëri-tjetrin. Komenti i paraqitur nga institucioni nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon.

4. Në lidhje me Fushën 2 Standardi II.2

Përgjigje e GVJ:

GVJ vlerëson pozitivisht faktin që institucioni ka marrë masa për të plotësuar mungesën e stafit ndihmës-akademik në mbështetjen e zhvillimit të orëve laboratorike. Megjithatë, RVJ është hartuar bazuar në dosjen e vetë-vlerësimit dhe në vizitën që GVJ ka kryer në institucion, kohë në të cilën institucioni nuk kishte të angazhuar staf ndihmës-akademik. Komenti nuk merret në konsideratë dhe RVJ nuk ndryshon.

5. Në lidhje me Fushën 2 Standardi II.2

Përgjigje e GVJ:

Nga komenti, vlerësimi i grupit të ekspertëve në lidhje me nevojën e përditësimit të syllabuseve konsiderohet i drejtë dhe pranohet nga institucioni.

Në lidhje me komentimin e e dytë në këtë fushë, theksojmë se qëllimi i këtij vlerësimi është përmirësimi i vazhdueshëm në funksion të cilësisë në tërësi të procedurave dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni. Në këtë kuadër, GVJ mendon që përsëritja e informacionit mund të bëhet burim inkonsistencash në rastet e përditësimit të njërës prej rregulloreve dhe sugjerimi nuk lidhet me ligjshmërinë. Vlerësimi vjen në formën e një sugjerimi që nuk lidhet me ligjshmërinë. Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.

6. Në lidhje me Fushën 2 Standardi II.4

Përgjigje e GVJ:

Vlerësimi i ekspertëve për këtë pikë i referohet materialit të vënë në dispozicion të GVJ nga institucioni. Në hartimin e RVJ, grupi i ekspertëve është mbështetur tek kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018, “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë” dhe VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë” dhe nuk gjykon në lidhje me procese të mëparshme të institucionit apo të programit të studimit.

GVJ thekson edhe njëherë rëndësinë e hartimit dhe zbatimit me korrektësi nga institucioni të planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve. Këto dokumenta të miratuar nga instancat më të larta të IAL duhet të jenë në harmoni me njëri-tjetrin.

GVJ ka analizuar me përgjegjësi planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.

7. Në lidhje me Fushën 3 Standardi III.3

Përgjigje e GVJ:

(i) GVJ vlerëson pozitivisht faktin që institucioni është i ndërgjegjshëm për nevojën e kontrollit antiplagjiaturë për tezat e diplomave master. Gjithashtu, vlerësohen iniciativat dhe përpjekjet e stafit akademik për të ruajtur cilësinë e punimeve të diplomave me anë të aplikacioneve të ndryshme web. Nga ana institucionale, GVJ nuk gjen të mbështetur me dokumentacion (rregullore, udhëzues, programe apo licenca) kontrollin antiplagjiaturë për sigurimin e cilësisë së punimeve të diplomave master. Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.

(ii) Nga komenti, vlerësimi i grupit të ekspertëve në lidhje me inkonsistencat midis rregulloreve në lidhje me procesin e përshkallëzimit të ankimimit, konsiderohet i drejtë dhe pranohet nga institucioni. RVJ nuk ndryshon.

8. Në lidhje me Fushën 4 Standardi IV.1

Nga komenti i institucionit konstatohet që vlerësimi i GVJ pranohet nga institucioni.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Kolegji Universitar i Biznesit (KUB) është Institucion Jopublik i Arsimit të Lartë i llojit Kolegj Universitar që ushtron veprimtari në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive profesionale dhe atyre krijuese në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” që ofrohet nga ky institucion, jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare të vendit, por kontribuon direkt në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin dhe modernizimin e vendit.</p> <p><i>Dok.1 Statuti KUB</i></p> <p><i>Dok. 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2021-2026</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>KUB zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me misionin e tij të shprehur qartë në nenin 4 në Statutin e KUB.</p> <p>Misioni, vizioni dhe objektivat e këtij programi studimi janë të tilla që mundësojnë hedhjen e bazave shkencore dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për formimin e studentëve. Programet e studimit në KUB janë të hartuara duke iu përshtatur kërkesave të Kartës së Bolonjës, të cilat mundësojnë transferimin e krediteve dhe nxisin mobilitetin e studentëve tek IAL partnere brenda dhe jashtë vendit. Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile: “Informatikë Biznesi”, “Teknologji</p>

	<p>Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e KUB.</p> <p><i>Dok.1 Statuti KUB</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2021-2026</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” është hartuar në përputhje me misionin, vizionin dhe qëllimet e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit.</p> <p>Strategjia e Zhvillimit të KUB për periudhën 2021-2026 ka si objektiv konsolidimin e programeve të studimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe riorganizimin e IAL deri në hapjen e një njësie kryesore të re, “Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit”. Në vizionin e KUB synohet përgatitja e profesionistëve për të konkuruar dhe punuar në një treg pune me standarde të larta dhe eksperiencë të përparuar në nivel kombëtar, rajonal dhe atë të Bashkimit Evropian, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit duke kontribuar në rritjen e ekonomisë dhe standardeve të demokracisë në vend.</p> <p><i>Dok.1 Statuti KUB</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e “Kolegjit Universitar i Biznesit”</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar i Biznesit, 2021-2026</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin</p>	<p>Duke iu referuar “Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030” dhe “Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030” ku përcaktohet si objektivi strategjik:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Zgjerimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit; – Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik; – Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës mbështetëse të kërkimit shkencor (infrastrukturës akademike)

përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare;</p> <p>GVJ është i mendimit se programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” është në përputhje me këto strategji në shërbim të interesit kombëtar si edhe në përputhje me trendet globale të zhvillimit.</p> <p><i>Dok.1 Statuti KUB</i></p> <p><i>Dok. 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2021-2026</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit, Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” ofrohet në Kolegjin Universitar të Biznesit, në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe aktivitetin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare në përputhje edhe me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit GVJ konstaton që KUB ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”. Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” është Fakulteti i Ekonomisë, i cili ka në përbërje tre njësi bazë:</p> <p>– Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;</p>

– Departamenti i Menaxhimit;

– Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës;

Nga të dhënat që jepen në dosjen e vetëvlerësimit, rezulton numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvojë dhe të përshtatshme në disiplinat specifike të këtij programi studimi. Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) i angazhuar në këtë program studimi, në vitin akademik 2022-2023 kanë kualifikimet si më poshtë:

Kualifikimi	PAE	PAK
Prof. Dr.	1	0
Prof. Asoc.	1	0
Dr./PhD	4	3
Dr. në proces	0	0
Msc.	2	0
Total	8	3

Në Departamentin e Ekonomiksit dhe Informatikës, i cili është përgjegjës për programin e studimit, rezultojnë 7 staf akademik efektiv dhe 9 staf akademik me kontratë, të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi	PAE	PAK
Prof. Dr.	0	1
Prof. Asoc.	0	2
Dr./PhD	3	4
Dr. në proces	0	0
Msc	4	2
Total	7	9

Të dhënat statistikore për periudhën 2020-2023 shprehin qëndrueshmëri të stafit akademik PAE në këtë departament. Stafit akademik ka kualifikimin e duhur për formimin e njësisë bazë si dhe angazhimi i tyre akademik është në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës, megjithatë GVJ vë në dukje që stafi akademik i departamentit përgjegjës për programin e studimit nga 7 anëtarë gjithësej, 4 prej tyre janë me gradë shkencore Master dhe si të tillë

	<p><i>nuk mund të angazhohen në mësimdhënie në programe studimi Master Shkencor (bazuar në ligjin e arsimit të lartë). Rrjedhimisht, pjesa me e madhe e ngarkesës së programit të studimit mbulohet nga staf akademik jashtë departamentit dhe staf i jashtëm.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që IAL të marrë masa për të rritur numrin e stafit akademik të departamentit me tituj dhe grada.</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i> <i>Dok. 31. Lista e Pedagogëve në KUB për Vitin Akademik 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë i cili ofron programe studimi akademike dhe kërkimore në fushën e Ekonomisë</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë në KUB ka në përbërjen e tij 3(tre) departamente”:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Departamenti Financë dhe Kontabilitet – Departamenti i Menaxhimit – Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës <p>GVJ mendon që programi i studimit ofrohet nga njësia kryesore që ka fushë akademike të ngjashme me atë të këtij programi studimi. GVJ vlerëson pozitivisht riorganizimin institucional, për të cilin KUB është aktualisht në proces, në të cilin programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” do të ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Aplikuar, njësi bazë e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike.</p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FE</i> <i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës</i> <i>Dok.Shtese - Nr 62 Prot Date 06.02.2024 Miratimi i rioorganizimit</i> <i>Dok. 22. Studimi i Tregut të Punës për Programin e Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i> <i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i> <i>Dok.Shtese - Vendim 2 miratimin e ndryshimeve ne organigram dhe statut</i></p>

<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe njësisë bazë përgjegjëse për këtë program është Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës. Programi është liçensuar në vitin 2021, me urdhër Numër 340 të Ministrit të Arsimit, datë 17.09.2021 si kurrikul e ofruar nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës në Fakultetin e Ekonomisë në Kolegjin Universitar të Biznesit. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës ofron programet e studimit Bachelor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informatikë Biznesi; - Teknologji Informacioni; <p>dhe programin Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”. GVJ mendon që programi i studimit ofrohet nga njësi bazë që ka fushë akademike të ngjashme me atë të këtij programi studimi. KUB është aktualisht në proces riorganizimi dhe sipas organigramës së re të paraqitur nga IAL, përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” do të jetë Departamenti i Informatikës së Aplikuar.</p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FE</i> <i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës</i> <i>Dok.Shtese - Nr 62 Prot Date 06.02.2024 Miratimi i rioorganizimit</i> <i>Dok. 22. Studimi i Tregut të Punës për Programin e Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i> <i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i> <i>Dok.Shtese - Vendim 2 miratimin e ndryshimeve ne organigram dhe statut</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohe</p>	<p>Nuk Aplikohet</p>

nga institucionet partnere.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>KUB në mënyrë të vazhdueshme organizon, leksione të hapura, debate, bashkëbisedime me studentë dhe pedagogë personalitete apo përfaqësues nga kompanitë me të cilat ka marrëveshje apo institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës organizon aktivitete jashtë-kurrikulare si: trajnime workshope, simulation game, etj. Pranë KUB është ngritur Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes (ISAB), i cili funksionon si një organizatë jofitimprurëse. Ky institut synon trajnim gjatë gjithë jetës të profesionistëve dhe ekspertëve nëpërmjet trajnimeve afatshkurtra.</p> <p><i>Dok. 9. Rregullore e zyrës së Karrierës</i> <i>Dok. 57. Program trajnimi ISAB SKKSNK & Çertifikatë</i> <i>Dok. 28.3. Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare që janë zhvilluar në KUB përgjatë viteve akademike 2020-2021 , 2021-2022 , 2022-2023</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Ekonomisë dhe Informatikës ofrojnë programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" i cili është në përputhje me fushën e tyre akademike. Stafit akademik i njësisë kryesore dhe bazë ka kualifikimin e duhur sipas ligjit dhe angazhimi i tyre akademik është në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës. GVJ vë në dukje që stafi akademik i departamentit përgjegjës për programin e studimit nga 7 anëtarë gjithsej, 4 janë me gradë shkencore Master dhe si të tillë nuk mund të angazhohen në mësimdhënie në programin e studimit Master Shkencor. Pjesa me e madhe e ngarkesës së programit të studimit mbulohet nga staf akademik jashtë departamentit ose staf i jashtëm.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që IAL të marrë masa për të rritur numrin e stafit akademik të departamentit me tituj dhe grada.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se KUB siguron bashkëpunim dhe realizon ndarjen e detyrave mes njësive dhe personelit akademik dhe administrativ sipas rregulloreve respektive, si dhe ndjekjen e zbatimit të tyre. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, i cili ka një kohëzgjatje 2-vjeçare dhe në total përmban 120 kredite.</p> <p>GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara në aktet rregullatore të institucionit. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Bashkëpunimi i strukturave dhe njësive kryesore/bazë në KUB realizohet në përputhje me nivelin hierarkik të përcaktuar në organigramën e IAL-së.</p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”</i> <i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i> <i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”</i> <i>Dok. 19. Organigrama e Kolegjit Universitar “I Biznesit” & Vendimi i Senatit Akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë</p>	<p>Në mbështetje të strategjisë së zhvillimit institucional të KUB, ku përcaktohet si prioritet zgjerimi i bashkëpunimeve dhe ndërkombëtarizimi, KUB ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi si me institucione të tjera të arsimit të lartë ashtu edhe me subjekte ekonomike private dhe institucione të tjera shtetërore. Bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, nga takimi me studentët, me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, me zyrën përgjegjëse</p>

<p>vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>për marrëdhëniet më jashtë, u konstatua se institucioni ka bashkëpunime me IAL-të vendase dhe të huaja dhe me kompani biznesi. KUB ka paraqitur në dosjen e vetevlerësimit 182 marrëveshje bashkëpunimi institucionale me partnerë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Vlen të theksohet edhe rëndësia që KUB i ka kushtuar përfshirjes në programet Erasmus+, KA1 për të shkëmbyer eksperiencat më të mira në procesin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe përdorimit të metodave inovative për stafin akademik dhe studentët. KUB ka filluar implementimin e projekteve Erasmus+, KA1 (International Credit Mobility) duke filluar në viti 2021 dhe aktualisht ka aktive 15 marrëveshje të tilla. Për harkun kohor 2022-2023 kanë përfituar mobilitet në kuadër të Erasmus+ 18 studentë dhe staf akademik, ndërsa për vitin akademik 2023-2024 janë parashikuar të realizohen 42 mobilitete studentë/staf akademik.</p> <p><i>Dok.2 Plani Strategjik i zhvillimit te KUB</i></p> <p><i>Dok. 27.1. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët për programin e projekteve ne kuader te Erasmus+</i></p> <p><i>Dok. 27.3. Raport i planifikimit të zhvillimit të aktiviteve të KUB nga Marrëveshjet Erasmus +</i></p> <p><i>Dok.30.1 Lista e marreveshje te bashkepunimit me partnere kombetare dhe nderkombetare</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informaticioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, i ofruar nga KUB, parashikon në planin mësimor lëndën “Praktikë/Stazh 3-mujor” që zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve dhe i korespondojnë 12 kredite ECTS.</p> <p>Në realizimin e Praktikës institucioni mbështetet në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar me një sërë kompanish në fushën e Teknologjisë së Informacionit. Zhvillimi i praktikës profesionale gjendet i pasqyruar në Nenin 13 të rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informaticioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”. Për monitorimin e praktikës profesionale institucioni ka hartuar Udhëzuesin e Praktikës</p>

<p>e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Profesionale të miratuar nga Senati Akademik. Zhvillimi i praktikës profesionale realizohet nën drejtimin e një pedagogu me eksperiencë të përcaktuar me urdhër Dekani, i cili ndjek nga afër çdo student për angazhimin dhe mënyrën e trajtimit të problemeve që lidhet me njësinë ekonomike apo institucionin ku kryen praktikën. Institucioni ka paraqitur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi ndër-institucionale me institucione shtetërore dhe IAL partnere, si dhe me kompani private brenda dhe jashtë vendit, në funksion dhe të realizimit të praktikës profesionale.</p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. 55. Udhëzues për përgatitjen e Praktikës Profesionale</i></p> <p><i>Dok. 27.1. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët për programin e projekteve ne kuader te Erasmus+</i></p> <p><i>Dok. 27.3. Raport i planifikimit të zhvillimit të aktiviteve të KUB nga Marrëveshjet Erasmus +</i></p> <p><i>Dok.30.1 Lista e marreveshje te bashkepunimit me partnere kombetare dhe nderkombetare</i></p> <p><i>Dok. Shtese - Urdher per caktimin e pedagogut per ndjekjen e praktikave</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Ne nivel institucional KUB përgatit një raport vjetor ku ndër të tjera analizon marrëveshjet e bashkëpunimit dhe përfitimet nga praktikat profesionale. Në nivel njësie kryesore, Fakulteti i Ekonomisë harton analizë semestrale ku detajon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies 2. Realizimin e kërkimit shkencor 3. Realizimin semestral te objektivave të FE 4. Bashkëpunimet ndër-institucionale dhe pjesëmarrjen në projekte 5. Produktet në fushën e projekteve dhe mobiliteteve Erasmus+ 6. Të dhëna për NJSBC <p>Në analizat semestrale dhe vjetore evidentohen efektet pozitive dhe përfitimet e marrëveshjeve në tërësi në funksion të realizimit të qëllimeve të këtij programi studimi, por edhe të evidentimit të</p>

	<p>mangësive të tyre. Këto analiza miratohen nga Senati akademik i KUB.</p> <p>GVJ vlerëson punën e KUB dhe në veçanti të FE për evidentimin e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, por nuk gjen të pasqyruar rolin e njësisë bazë (Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës), në monitorimin e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit që ofron.</p> <p><i>GVJ sugjeron departamentin të realizojë raporte analitike vjetore të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit bazuar në rekomandimet e pedagogëve përgjegjës për ndjekjen e praktikave profesionale në programet e studimit të ofruara nga departamenti.</i></p> <p><i>Dok. 21.2. Analiza Mësimore Kërkimore DEI 2022-2023</i></p> <p><i>Dok. 27.1. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët për programin e projekteve ne kuader te Erasmus+</i></p> <p><i>Dok 55 Udhezues per pergatitjen e Praktikës Profesionale</i></p> <p><i>Dok. Shtese - Urdher per caktimin e pedagogut per ndjekjen e praktikave</i></p>			
Konkluzione	<p><i>KUB nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere si dhe aktorë të tregut të punës dhe i analizon ato në mënyrë periodike.</i></p> <p><i>Sugjerohet të hartohen në nivel njësie bazë raporte analitike vjetore të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit bazuar edhe në rekomandimet e pedagogëve përgjegjës për ndjekjen e praktikave profesionale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1					
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.					
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” është ndërtuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>GVJ gjeti të përcaktuar elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” dhe bazën ligjore mbi të cilën ai është ndërtuar dhe funksionon në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu IV, rregulloren e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës, Neni 20 dhe në rregulloren e programit të studimit, nenet 4, 7, 8.</p> <p>GVJ vlerësoi elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” dhe i krahasoi me elementët e shprehur në VKM nr. 41, datë 24.1.2018 për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë (ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; nr. 185, datë 25.3.2021). Për sa më sipër, GVJ konstaton si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Programi ofrohet në 2 vite akademike, 4 semestra dhe me kohë të plotë, ku çdo semestër përmban përkatësisht (24 ECTS, 36 ECTS, 24 ECTS dhe 36 ECTS) me në total 120 kredite ECTS. – Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit sanksionohen në Rregulloren e programit të studimit, Neni 12: citojmë: “Kontrolli i dijeve realizohet me shkrim, me gojë ose në mënyrë të kombinuar. Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë 0 – 100 dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë sipas tabelës së mëposhtme: <table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Pikët</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1-40</td> <td>4</td> </tr> </tbody> </table>	Pikët	Nota	1-40	4
Pikët	Nota				
1-40	4				

41-50	5
51-60	6
61-70	7
71-80	8
81-90	9
91-100	10

Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Pikët për notën përfundimtare janë rezultante e kombinimit të elementëve në raportet:

Vlerësimi për lëndën/modulin është: vlerësim i vazhduar + vlerësimi për provimin përfundimtar				
1. Vlerësimi i vazhduar (1-40 pikë)			2. Provim i përfundimtar (1-60 pikë)	Totali i pikëve (1+2) (1-100 pikë)
Pjesëmarrje (10 pikë)	Aktivizim (10 pikë)	Teste/detyra (20 pikë)		

Vlerësimi i vazhduar në masën 40% është i detyrueshëm, por në rastet e lëndëve aplikative, pedagogu ka të drejtë të organizojë një shpërndarje të ndryshme të peshës së elementëve të vlerësimit të vlerësimit të vazhduar duke e përcaktuar atë në syllabusin e lëndës."

Të njëjtat forma të kontrollit të dijeve dhe vlerësimit, GVJ i gjen të shprehura/përsëritura edhe në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Neni 47. Pavarësisht së gjatë vizitës në IAL, drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë na vunë në dijeni që kjo përsëritje është e qëllimshme për të siguruar përcimin e informacionit tek stafi dhe studentët.

GVJ mendon që përsëritja e informacionit mund të bëhet burim inkonsistencash në rastet e përditësimit të njërës nga rregulloret.

GVJ rekomandon IAL të evitohet përsëritje informacioni, sikurse është tabela e vlerësimit.

Duke qenë se konvertimi i pikëve të vlerësimit në notë është i njëjtë, rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e fakultetit, është mjaftueshëm të citohet si referencë rregullorja e me e lartë në hierarki.

	<p>Gjithatu, GVJ nuk gjen të përcaktuara lëndët aplikative për të cilat sipas rregullores nuk zbatohet vlerësimi i vazhdueshëm dhe i detyrueshëm 40%.</p> <p><i>GVJ sugjeron që njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të përcaktojë grupin e lëndëve aplikative që përjashtohen nga kjo pikë e rregullores ose ta konsiderojë formën e vlerësimit të dijeve si pjesë e lirisë akademike të titullarit të lëndës të përcaktuar në syllabus.</i></p> <p>Zhvillimi dhe vlerësimi i praktikës profesionale gjendet i pasqyruar në Nenin 13 të rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”. Për monitorimin e praktikës profesionale institucioni ka hartuar Udhëzuesin e Praktikës Profesionale të miratuar nga Senati Akademik. Mbrojtja e diplomës realizohet me temë diplome dhe vlerësohet me notë dhe me kreditet përkatëse sipas planit mësimor bazuar në rregulloren e programit të studimit, Neni 18, pika 3. IAL ka vënë në dispozicion të studentëve edhe paketën udhëzuese për mbrojtjen e diplomës.</p> <ul style="list-style-type: none"> – Rezultatet e të nxënit dhe kompetencat profesionale janë përcaktuar në syllabuset për secilën lëndë – Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, ndahen në mësim në auditor (leksione, seminare, laboratorë) të përcaktuara në planin mësimor të programit të studimit sipas krediteve ECTS që ka secila lëndë. – Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). – Plani mësimor përmban lëndët të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese në vite e semestra dhe kreditet përkatëse. Në programin e studimit kemi shpërndarjen 1275 orë në auditor dhe 1725 orë individuale, pra gjithësej 3000 orë). – Kuotat e pranimit miratohen çdo vit nga senati akademik i KUB dhe përcillen në QSHA. Numri i studenteve në grupet mësimore të programit të studimit plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në SHTOJCË NR. 2 (ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019). – Syllabuset e lëndëve janë të organizuara sipas strukturës së parashikuar nga VKM 41. GVJ konstaton që syllabuset e lëndëve
--	---




	<p>përcaktojnë orët në auditor për veprimtaritë formuese leksione dhe seminare por nuk përcaktojnë ngarkesë në orë laboratorike, rrjeshimisht shpërndarja e ngarkesës në syllabuse <u>NUK përputhet</u> me planin mësimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> - IAL disponon modelin e diplomës dhe suplementin që lëshon për studentët në përfundim të programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”. - KUB vepron bazuar në Rregulloren e Këshillit të Etikës të miratuar me vendim Senati. <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. 11 Rregullore e Keshillit te Etikes</i></p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. 23. Model Diplome MSc në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. 25.1. Propozimi i Kuotave në MAS 2022-2023</i></p> <p><i>Dok. 25.2. Propozimi i Krieteve në MAS 2023-2024</i></p> <p><i>Dok. 60. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2022-2023 TI</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2021-2022 IB</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të</p>	<p>Programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” synon”:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dhënien e një tërësie njohurish në formimin teorik si edhe kërkimin shkencor në fushën e shkencave informatike - Të formojë specialistë të lartë informaticienë biznesi dhe specialistë të lartë në fushën e E-commerce dhe Inovacionit. - Të plotësojë njohuritë e studentëve edhe në fusha të tjera ndihmëse si: financë, qeverisje të korporatave, drejtim financiar, ekonometri e avancuar dhe menaxhim të integruar të projekteve. <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”</i></p>




<p>teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, në kurrikulën e tij parashikon në total 15 lëndë mësimore si dhe Diplomën dhe Praktikën për një total prej 17 lëndë/module didaktike të ndara në veprimtari formuese në kategoritë A-E.</p> <p>Zhvillimi i praktikës/stazh 3 -mujor si veprimtari formuese ka të përcaktuar ngarkesën me 12 kredite ECTS në kategorinë D – Lëndë Plotësuese. Mbrojtja e diplomës është parashikuar si detyrim përmbyllës me 18 kredite ECTS në kategorinë “E”, duke përbërë 15% të peshës totale të programit. Pesha totale e Praktikës Profesionale është 10% të peshës totale të programit.</p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësimit i ciklit të parë</p>	<p>Nuk aplikohet</p>

<p>Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>




<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>KUB nuk gëzon status të veçantë.</p> <p>Nuk aplikohet</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues të këtij raporti, të vëna në dispozicion nga KUB, dhe duke i krahasuar ato me programe të ngjashme studimit të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë në vend. Bazuar në listën e programeve të akredituara nga ASCAL dhe të publikuar në faqen web zyrtare, po përmendim disa prej tyre :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Instituti Kanadez i Teknologjisë <ul style="list-style-type: none"> o Master shkencor në “Teknologji Informacioni në Biznes” - Universiteti Luarasi <ul style="list-style-type: none"> o Master shkencor në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” - Universiteti European i Tiranës <ul style="list-style-type: none"> o Master shkencor në “Teknologji Informacioni” <p>Vihet re se plani mësimor në emërtime lëndësh, por edhe në shpërndarje, është i ngjashëm me programet e ofruara nga IAL të tjera brenda vendit dhe në përputhje me objektivat e formimit të këtij programi studimi.</p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p>

	<i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentacionit shoqërues si dhe VKM nr. 310, datë 11.05.2022 për “Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kodifikimi i këtij programi studimi është përcaktuar nga KUB me kodin: 72MS0622S dhe përcjellë në ministrinë përgjegjëse për arsimin me shkresë zyrtare datë 30.06.2023 Nr. 283 Prot. i KUB. <i>Dok.26 Shkresa derguar ne MAS per kodifikimin e programeve te studimit</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit nuk është program studimi i përbashkët me IAL të tjera.
Konkluzione	<i>Programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” i cili ofrohet në 2 vite akademike, 4 semestra me kohë të plotë, në total me 120 kredite ECTS, është ndërtuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi ka të përcaktuar kreditet përkatëse për zhvillimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse. <u>Rekomandojmë:</u></i>

	<ul style="list-style-type: none"> - të evitohen përsëritje informacioni, sikurse është tabela e vlerësimit në rregulloren e FE, rregulloren e programit të studimit dhe në syllabuse; - njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të përcaktojë lëndët aplikative për të cilat sipas rregullores nuk zbatohet vlerësimi i vazhdueshëm dhe i detyrueshëm 40%; - përditësimin e përmbajtjes së syllabuseve konform planit mësimor duke saktësuar kreditet dhe orët mësimore për secilin aktivitet didaktik (Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi, praktika etj.) në përputhje edhe me rregulloret e brendshme institucionale. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2			
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Kolegji Universitar i Biznesit, ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.03, datë 07.01.2022 që akrediton në formë institucionale me vlefshmëri 4 vite, deri në 06/01/2026. Fakulteti i Ekonomisë, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 3 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit; 2. Departamenti i Menaxhimit; 3. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës; <p>Duke përmbushur kështu edhe kriteret ligjore për qëndrueshmërinë e njësisë kryesore. Në total Fakulteti i Ekonomisë ofron 8 programe studimi përkatësisht 3 në ciklin e parë Bachelor, 3 programe studimi në ciklin e dytë MSC dhe 2 programe studimi në ciklin e dytë Mastër Profesional. Fakulteti i Ekonomisë ka në përbërjen e tij, 22 personel akademik efektiv(PAE) i ndarë në tre njësi bazë, si:</p>		
	Njësia bazë	Nr. PAE	Tituj/Grada

	Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit	7	2 – Prof. Dr. 0 – Prof. Asoc. 3 – Dr. 0 – Dr. në Proc. 2 – Msc
	Departamenti i Menaxhimit	8	0 – Prof. Dr. 1 – Prof. Asoc. 3 – Dr. 0 – Dr. në Proc. 4 – Msc
	Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës	7	0 – Prof. Dr. 0 – Prof. Asoc. 3 – Dr. 0 – Dr. në Proc. 4 – Msc
	Total	22	

Siç duket edhe nga tabela e mësipërme, PAE me grada shkencore në Fakultetin e Ekonomisë në vitin 2022-2023 zë rreth 55% të stafit akademik efektiv të njësisë kryesore. Secila njësi bazë, pëfshirë edhe Departamentin e Ekonomiksit dhe Informatikës, përmbush kriteret minimale të parashikuar në ligjin 80/2015 për numrin dhe kualifikimin minimal të stafit efektiv për krijimin dhe ekzistencën e njësisive bazë. Stafit akademik efektiv dhe me kontratë i departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës për dy vite akademike janë sipas tabelës më poshtë :

Kualifikimi i stafit akademik të DEI	2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	0	0	0	1
Prof. Asoc.	0	2	0	2

	Dr/Phd	3	6	3	4
	Msc.	5	1	4	2
	Gjithsej	8	9	7	9
	<p><i>Dok. 18.1. Çertifikatë Akreditimi KUB</i></p> <p><i>Dok.1 Statuti KUB</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit"</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 19. Organigrama e Kolegjit Universitar "I Biznesit" & Vendimi i Senatit Akademik</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p>				
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<p>Fakulteti i Ekonomisë nuk angazhon staf ndihmës-akademik të dedikuar në mbështetje të procesit mësimor. Gjatë vizitës në KUB, GVJ u njoh me disa nga detyrat e stafit akademik efektiv të institucionit, ndër të cilat mbështetja për realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorike. Aktualisht, në KUB 2(dy) anëtarë të stafit akademik angazhohen në mirëmbajtjen e laboratorëve dhe përditësimin e infrastrukturës softwarike.</p> <p><i>GVJ sugjeron angazhimin e personelit ndihmës-akademik të dedikuar për mbështetjen e stafit akademik dhe studentëve në zhvillimin dhe realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorëve.</i></p> <p><i>Shenime nga vizita</i></p> <p><i>Dok. 19. Organigrama e Kolegjit Universitar "I Biznesit" & Vendimi i Senatit Akademik</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p>				
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe	<p>Bazuar në RVB, dhe në rregulloren e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës, IAL nuk cakton një koordinator për programin e studimit. Në funksionet dhe detyrat e Përgjegjës të Departamentit të shprehura në rregulloren e njesisë bazë, përgjegjësi i njesisë bazë ndjek ecurinë e programit të studimit dhe zhvillimin e praktikave profesionale. Pra, sipas rregulloreve të brendshme institucionale, rolin e koordinatorit të programit të studimit e kryen përgjegjësi i departamentit që ofron programin e studimit.</p> <p><i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës, Neni 9</i></p>				

praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Raporti i Vleresimit te Brendshem Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike			
Konkluzione	Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës, përgjegjës për programin e studimit, përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë. <u>GVJ sugjeron</u> angazhimin e personelit ndihmës-akademik të dedikuar për mbështetjen e stafit akademik dhe studentëve në zhvillimin dhe realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës, si njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e Programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Një pjesë e këtij informacioni publikohet dhe në faqen web zyrtare të KUB. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës, disponon informacionet dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: rregulloren e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit etj.</p> <p>GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit, si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm mbi detyrimin e frekuentimit / ndjekjes së programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj. Sipas rregullores se FE, frekuentimi i leksioneve dhe seminareve është i detyrueshëm në masën 50%.</p> <p>Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas formatit të miratuar sipas VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në</p>

	<p>VKM nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar dhe informojnë në lidhje me detyrimin për frekuentimin/ ndjekjen e programit nga studenti, mënyrën e vlerësimit të dijeve, literaturën, sasia e orëve mësimore në total për çdo tematikë të lëndës, pedagogun e lëndës etj.</p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. 23. Model Diplome MSc në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. 25.1. Propozimi i Kuotave në MAS 2022-2023</i></p> <p><i>Dok. 25.2. Propozimi i Kritereve në MAS 2023-2024</i></p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2022-2023 TI</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2021-2022 IB</i></p> <p><i>Dok. 24. Relacion argumentues MAS, në kuader të aplikimit për riorganizimin e KUB</i></p>										
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” është i strukturuar në 2 vite akademike të organizuara në 4 semestra.</p> <p>Zhvillohen gjithsej 17 lëndë të ndara sipas 2 viteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> – 10 lëndë në vitin e parë; – 7 lëndë në vitin e dytë; <p>Në vitin e dytë është parashikuar edhe Praktika/stazhi 3-mujor me 12 kredite ECTS dhe Mbrojtja e Diplomës me 18 kredite ECTS. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.</p> <table border="1" data-bbox="571 1845 1370 1899"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Tipi</th> <th>ECTS</th> <th>%</th> <th>Standardi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi					
Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi							

	A	Lëndë bazë	12	10%	5 - 10%
	B	Lëndë karakterizuese	60	50%	50 -60%
	C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	18	15%	12 – 20%
	D	Lëndë plotësuese	12	10%	10%
	E	Detyrime përmbyllëse	18	15%	10 – 15%
	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite. IAL ka parashikuar në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve numrin total të krediteve ECTS dhe ndarjen e tyre në aktivitete formuese si Leksione, Ushtrime/Seminare, Laboratorë, detyra/Projekte kursi, praktika, etj. si dhe orët në total për cdo lëndë në auditor/ jashtë auditorit.</p> <p>GVJ konstaton që plani mësimor edhe pse parashikon 1 kredit ECTS për orët laboratorike, nuk parashikon ngarkesë në orë mësimore në auditor për këtë aktivitet sic parashikon për leksionet dhe seminarat. Sa më sipër vështirëson punën e ekspertëve për përcaktimin e raportit teori-praktikë apo vlerësimin e mjaftueshmërisë së ambienteve laboratorike në dispozicion të programit të studimit. <i>GVJ sugjeron përcaktimin e ngarkesës mësimore për aktivitetin didaktik, Laborator.</i></p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2022-2023 TI</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2021-2022 IB</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p>				
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e	<p>Kriteret e përgjithshme pranimit që duhet të plotësojnë kandidatët e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” janë të përcaktuara në “Nenin 5 “Kriteret e Pranimit” të rregullores së</p>				

<p>përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>programit të studimit. Konkretisht në programet e Fakultetit të Ekonomisë pranoen të gjithë kandidatët që kanë përfunduar arsimin parauniversitar të përgjithshëm ose profesional dhe ata që zotërojnë një diplomë të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga QSHA. Nota mesatare për regjistrimet e reja i referohet VKM respektive.</p> <p>Kriteret dhe procedurat specifike lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e tyre janë përcaktuar në Rregulloren për Ekuivalentimin e Studimeve të KUB. Njohja dhe transferimi i studimeve kryhet në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga studenti në fillim të vitit akademik. Komisioni i Ekuivalentimit të studimeve është autoriteti vendimmarrës për akuivalentimin e studimeve, i miratuar nga Senati Akademik, i cili funksionon si organ kolegjal në nivel IAL, me të paktën 3 anëtarë nga secila njësi kryesore e KUB. Dosjet e studentëve shqyrtohen kolegjalisht dhe komisioni shprehet për secilin student për kriteret e plotësuar dhe detyrimet. Në bazë të vendimit të komisionit nxirret akti administrativ i rektorit/dekanit dhe sekretaria vazhdon procedurat administrative të regjistrimit.</p> <p>Në lidhje me Komisionin e Ekuivalentimit, GVJ gjen gjithashtu të pasqyruar në rregulloren e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës, neni 28 të cituar si në vijim: “Komisioni i Ekuivalentimit dhe Transferimit të studimeve është organ kolegjal prane Fakultetit të Ekonomisë në KUB. Ai ngrihet me urdhër Dekani me propozim të përgjegjësit të DEI dhe funksionon sipas Rregullore së Ekuivalentimit dhe Transferimit të studimeve në KUB.”</p> <p>GVJ gjen rolin e Komisionit të Ekuivalentimit të studimeve të përsëritur në të gjitha rregulloret institucionale, si: Rregullore për ekuivalentimin e studimeve Neni 4, Rregullore KUB Neni 75, Rregullore se Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës, Neni 28 dhe Rregullore së Fakultetit të Ekonomisë neni 33.</p> <p><i>GVJ sugjeron që IAL të evitojë përsëritjet e procedurave në të gjitha hierarkitë e rregulloreve institucionale.</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”, Neni 75</i></p>
--	--

	<p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. 48.1. Paketa e Regjistrimit të studentit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. 48.2. Rregullore për Ekuivalentimin e Studimeve.pdf</i></p> <p><i>Dok. 48.3. Model TIP për Vendimin e Komisionit të Ekuivalentimit</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, janë paraqitur programet e lëndëve të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E. Programi i lëndës përmban të dhëna si: pedagogu që zhvillon modulën/lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/lëndës kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit/lëndës; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin e tyre, si dhe literaturën bazë dhe atë të detyrueshme.</p> <p>Nga analiza e detajuar e syllabuseve të lëndëve të këtij programi studim, vihet re se në disa prej tyre është paraqitur pedagogu apo pedagogët e lëndës dhe jo titullari i saj. <i>Në disa raste, pedagogu i lëndës i paraqitur edhe në syllabus ka gradën shkencore Master që bien ndesh me ligjin e arsimit të lartë.</i> Kujtojmë se bazuar në ligjin e arsimit të lartë, personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie duhet të ketë së paku formimin e një cikli më të lartë se ai i programit të studimit ku angazhohet. Në rastin e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, stafi akademik që angazhohet në mësimdhënie duhet të jetë së paku me gradën shkencore “Doktor”. Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën totale për studentin, duke përcaktuar edhe ngarkesën në auditor për leksionet dhe seminarët, por nuk përcaktojnë ngarkesë në auditor për orët laboratorike, aktivitetet e cili sipas planit mësimor ka 1 kredit ECTS.</p> <p>GVJ është i mendimit që programi edhe pse përmban elementët e kërkuar nga VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime</p>





	<p>dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, ka nevojë për rishikime në përputhje me planin mësimor të programit të studimit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që IAL të rishikojë syllabus:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - të caktohen titullarët e lëndëve sipas ligjit; - të cilësohet viti akademik për të cilin syllabusi është miratuar; - të cilësohet programi i studimit dhe profili përkatës ku jepet lënda; - të plotësohet në syllabus ngarkesa në orë laboratorike në përputhje me planin mësimor; <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2022-2023 TI</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2021-2022 IB</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të përcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në përmbajtjen e programit të studimit, në fillim të çdo viti akademik. Bazuar në rregulloren e programit të studimit, përmbajtja e tij mund të rishikohet me kërkesë të njësisë bazë përgjegjëse për atë program studimi ose me kërkesë të zyrës së kurrikulave si rezultat i kërkesave të tregut të punës, dinamikave të brendshme ose me kërkesë të secilit pedagog. IAL disponon dhe ka vënë në dispozicion të GVJ dosjen e programit të studimit në shqip dhe anglisht. Për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, IAL nuk ka kryer ndryshime në planin mësimor dhe as ndryshime në syllabuset e lëndëve. Programi i studimit është realizuar për herë të parë nga IAL e cila gjithashtu aplikon për akreditim për herë të parë. GVJ i janë vënë në dispozicion dosjet e plota të arkivuara, të cilat përmbajnë syllabuset e lëndëve të këtij programi studimit.</p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”</i></p>

	<p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2022-2023 TI</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2021-2022 IB</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Ekonomisë dhe Informatikës, disponojnë informacionet e nevojshme për programin e studimit. Programi i ciklit të dytë është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite.</i></p> <p><i>GVJ nuk gjen të parashikuara orë në auditor për Laboratorët të cilët në planin mësimor janë vlerësuar me 1 kredit ECTS. Mungesa e orëve laboratorike të matshme në orë në auditor në secilën lëndë shihet nga GVJ si:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>- një mangësi në përvetësimin e njohurive sipas nevojave të tregut të punës;</i> <i>- mund të bëhet pengesë për transferimin e studentëve në programe të ngjashme studimi brenda dhe jashtë vendit;</i> <i>- nuk mundëson vlerësimin e mjaftueshmërisë së ambienteve laboratorike për të gjitha lëndët, programet e studimit dhe numrin total të studentëve;</i> <p><i>GVJ sugjeron që IAL:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>- të përditësojë syllabuset me titullarët e lëndëve sipas ligjit;</i> <i>- të shtojë në syllabuse vitin akademik për të cilin syllabusi është miratuar;</i> <i>- të cilësojë në syllabus programin e studimit dhe profilin përkatës ku jepet lënda;</i> <i>- të përcaktojë në syllabuse, orët në auditor për laboratorët</i> <i>- të evitojë përsëritjet e procedurave në të gjitha hierarkitë e rregulloreve institucionale</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” është një program i konceptuar që të kombinojë pjesën teorike me atë praktike. Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve. Lëndët në planin mësimor kanë të nevojshme aftësimin laboratorik dhe zhvillimin në ambiente laboratorike për aftësimin e studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe formimin e tyre profesional për tregun e punës.</p> <p><i>Mungesa e orëve laboratorike (sipas rekomandimeve në Standardi II.3) të matshme në orë në auditor në secilën lëndë shihet nga GVJ si mangësi.</i></p> <p>Megjithatë, gjatë vizitës në IAL, GVJ konstatoi që disa nga lëndët zhvillohen tërësisht në laboratorët e KUB. Personeli akademik është i përkushtuar ndaj dhënies së njohurive praktike studentëve dhe kjo vërehet edhe në takimin me studentët, ku prej tyre u konfirmua impenjimi i stafit akademik në orë praktike si në laborator ashtu edhe në punime individuale të studentëve. Programi i studimit parashikon edhe një lëndë në vitin e dytë të studimeve “Praktikë/stazh 3-mujor” me 12 kredite ECTS e cila mbështetet në marrëveshjet institucionale që IAL ka me kompani private e publike në vend.</p> <p>Gjithashtu, bazuar në anketimet e kryera nga Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës 95% e studentëve ALUMNI të programeve Master Shkencor në KUB janë të punësuar. Megjithëse ky anketim nuk përfshin studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, nga takimi me studentët GVJ u informua që shumica e tyre ishin aktualisht të punësuar. GVJ mendon që emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme për studentët e këtij programi studimi. Nga takimi me studentët e programit të studimit, pjesa më e madhe e studentëve ishin të punësuar në profilin e programit, në fusha si informaticien, zhvillues aplikacione, menaxher rrjetash, etj.</p>

	<p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2022-2023 TI</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2021-2022 IB</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p> <p><i>Dok. 54. Të dhënat e punësimit të Studentëve Alumni në KUB 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës në përfundim të çdo viti akademik realizojnë një analizë e cila shërben si bazë për vlerësimin e realizimit të objektivave të programit të studimit, identifikimin e nevojave për rishikim dhe përmirësimi në mënyrë që programi të përshtatet sa më mirë me nevojat e tregut të punës. Nga vlerësimi i planit mësimor, GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësisimit profesional.</p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2022-2023 TI</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2021-2022 IB</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program</p>	<p>Struktura e programit të studimit dhe lëndët janë në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në programin e studimit kemi shpërndarjen 1275 orë në auditor dhe 1725 orë individuale, pra gjithësej 3000 orë. Orët laboratorike praktike janë të përcaktuara në planin mësimor por GVJ nuk i gjen të matshme në orë mësimore në syllabuset e lëndëve, si rrjedhim nuk mund të gjykojë objektivisht në lidhje me raportin teori-praktikë. Vlen të theksohet që kërkesa për shtim të orëve praktike buron edhe nga rezultatet e pyetësorëve të studentëve të realizuara në vitin 2023 nga IQE.</p>




<p>duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p><i>Sugjerojmë institucioni të rishohë syllabuset duke shprehur qartazi ngarkesën për aktivitetet laboratorike, si një prej aktiviteteve më të rëndësishme në formimin e studentëve në fushën e këtij programi studimi.</i></p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Doc. 45.1. IQE report per student, 2023</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në këtë program studimi gjatë 2 viteve akademike zhvillohen lëndët të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese në vite e semestra dhe kreditet përkatëse. Në programin e studimit kemi shpërndarjen 1275 orë në auditor dhe 1725 orë individuale, pra gjithësej 3000 orë. Gjatë takimeve me personelin akademik dhe me studentët e programit të studimit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve dhe mobilitet gjatë studimit, si dhe aftësimin e tyre për tregun e punës në fushën e informatikës. Në këtë program studimi nuk ka studentë të transferuar, ndërsa për sa i përket mobiliteteve, KUB ofron për studentët e tij mundësi të ndryshme për të kryer mobilitet Erasmus+. Studentët janë angazhuar në punime shkencore individuale të pedagogëve, në projekte shkencore në rang departamenti dhe fakulteti apo në projekte në bashkëpunim me të tjerë.</p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i> <i>Evidencë Takimet me Zyrën e projekteve;</i> <i>Dok. 30.5. Marrëveshjet me Universitete e huaja për diplomat e dyfishta, Webster University</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesin e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës, GVJ evidentoi praktikën e punës së institucionit, ku në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit dhe diskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik. Në rregulloren e programit të studimit, parashikohet që</p>

<p>dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>titullari i modulit/lëndës është përgjegjës për hartimin dhe rifreskimin e moduleve, sidomos i atyre me profil informatik.</p> <p><i>Nga vlerësimi i literaturës së lëndëve, në syllabuse, konstatohet që për një pjesë të tyre viti i botimit të literaturës nuk është i viteve të fundit sipas kriterit përkatës.</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2022-2023 TI</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2021-2022 IB</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" garanton përfundimin e njohurive, aftësive themelore (aftësive teknike dhe aftësive të tjera), si dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2022-2023 TI</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2021-2022 IB</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe/ose punësimin e studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës. Kjo tregohet nga një shkallë e lartë e punësimit të të diplomuarve të studentëve në fushat e teknologjisë së informacionit në kompani si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. KUB sapo ka diplomuar brezin e parë të studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion", dhe 100% e studentëve të diplomuar rezultojnë të punësuar. GVJ gjykon që përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm</p>

	<p>të studimeve në fushën e kërkimit shkencor akademik ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2022-2023 TI</i></p> <p><i>Dok. shtese MSC 2021-2022 IB</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, në përputhje me nivelin 7 të KSHK-së, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës në fushën e programit të studimit.</i></p> <p><i>Në këtë program studimi nuk ka pasur ndryshime në planin mësimor të programit të studimit. KUB aplikon për akreditim për herë të parë.</i></p> <p><i>Struktura e programit të studimit dhe lëndët janë në përputhje me profilin e programit të studimit, por <u>GVJ sugjeron</u> të përcaktohet qartazi ngarkesa për aktivitetet laboratorike, si një prej aktiviteteve më të rëndësishme në formimin e studentëve në fushën e këtij programi studimi dhe të rishikohet literatura e cila në këtë fushë studimi ndikohet nga ndryshimet e shpejta teknologjike.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të	Fakulteti i Ekonomisë ka një marrëdhënie të konsoliduar bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës. Në marrëveshjet e bashkëpunimit që IAL ka me kompanitë, bizneset shprehen të gatshëm të pranojnë studentë për realizimin e praktikave profesionale dhe punësimin e studentëve. Në dosjen e realizimit të praktikës, kompanitë ku studenti ka kryer praktikën, plotësojnë me

<p>punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>vërejtje, sugjerime dhe propozime për përmirësimin e syllabuseve të lëndëve ose të programit të studimit. Bashkëpunimi është efektiv edhe në drejtim të punësimit të studentëve duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse të cilat merren në konsideratë nga njësia bazë për përmirësimin e programit të studimit.</p> <p>Dok 55 Udhezues per pergatitjen e Praktikes Profesionale</p> <p>Dok.30.1 Lista e marreveshje te bashkepunimit me partnere kombetare dhe nderkombetare</p> <p>Dok. 27.1. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët për programin e projekteve ne kuader te Erasmus+</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në KUB, studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale sipas statutit dhe rregullores së studimeve në KUB. Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, para çdo sezoni të provimeve realizon pyetësorë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies. Përveç pyetësorëve që realizohen nga NJBSC, KUB angazhon për zhvillimin e pyetësorëve edhe institucione të jashtme në mënyrë që të marrë mendime sa më të lira dhe të pavaruara nga ana e studentëve. Në bazë të rezultateve të pyetësorëve për studentët hartohet një raport mbi gjetjet e pyetësorit që miratohet nga Senati Akademik i cili miraton gjithashtu edhe planin e aktiviteteve për përmbushjen e rezultateve të pyetësorëve në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB. GVJ konstatoi që për hapjen e programit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, është kryer një studim tregu në vitin 2023. Gjithashtu, GVJ vlerëson hapat e ndërmarrë nga IAL për riorganizimin institucional dhe krijimin e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike bazuar në analizën e thelluar të tregut të punës dhe nevojave aktuale dhe ofertës akademike në vend për këtë profil programi.</p> <p><i>Dok 45.1 Raporti i IQE per student, 2023</i></p>




	<p><i>Dok 41 Raporti NJSBC per rezultatet e pyetesoreve ne vitin akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Dok 41.1 Plani i aktiviteteve per permbushje te rezultateve te pyetesoreve ne kuader te permiresimit te standarteve te cilesise Kub</i></p> <p><i>Dok. Shtese - Studim Tregu MSC TI,IB,ECM</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, realizon në mënyrë të përvitshme një analizë në tërësi të aktivitetit të saj, përfshirë edhe atë të nevojave për përmirësim të vazhduar të ofertës së saj didaktike. Zyra e kurrikulave koordinon njësinë bazë dhe atë kryesore për procesin e hartimit, ndryshimit, të organizimit të programeve mësimore dhe kurrikulave përkatëse.</p> <p><i>Dok. 21.2. Analiza Mësimore Kërkimore DEI 2022-2023</i></p> <p><i>Dok 45.1 Raporti i IQE per student, 2023</i></p> <p><i>Dok 41 Raporti NJSBC per rezultatet e pyetesoreve ne vitin akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Dok. 24. Relacion argumentues MAS, në kuader të aplikimit për riorganizimin e KUB</i></p> <p><i>Dok.8 Rregullore e Zyres se Kurrikulave</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Ekonomisë në tërësi, dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës në veçanti, analizojnë dhe marrin opinionet e bashkëpunorëve si nga tregu i punës ashtu edhe nga ai akademik i institucioneve partnere. IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët. Bashkëpunimi me industrinë është i frytshëm për realizimin e praktikave profesionale, punësimin e studentëve apo organizimin a aktiviteteve si panairë punë, ore/leksione të hapura, trajnime, etj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në strategjinë e zhvillimit të KUB si pjesë e vizionit të IAL përmendet ofrimi i një oferte akademike elastike për të ofruar një përvojë aktive tek studentë, kërkim shkencor të aplikuar me njohuri të përditësuara, shërbime me vështirësi ndaj biznesit dhe sipërmarrjes duke luajtur një rol kyç në zhvillimin e rrjeteve që mbështesin lidhjet ndërkombëtare përmes partnerëve dhe bashkëpunëtorëve të KUB. Më konkretisht në strategjinë e KUB në sesionin 5. Objektivat strategjike dhe qëllimet e KUB për periudhën 2021-2026, synohet që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Programet e studimeve të jenë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementët që përmbajnë duke afirmuar vlerët e arsimit të lartë në Shqipëri. – Njohja e plotë e programeve të studimit dhe diplomave me qëllim fitimin e të drejtës për të vazhduar më tej studimet pa dhënë shumë provime shtesë në institucionet pritëse. <p>GVJ gjykon që këta elementë gjejnë pasqyrim në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”.</p> <p><i>Dok. 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2021-2026</i></p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” është Fakulteti i Ekonomisë, i cili ka në përbërje tre njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit; – Departamenti i Menaxhimit; – Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës; <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomiksit dhe</p>

	<p>Informatikës, është njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit e cila koordinon gjithë veprimtarinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor të personelit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - bashkëpunon me njësitë e tjera të KUB me të cilat bashkërendon organizimin e konferencave, publikimet në revistën e institucionit, organizimin e evente shkencore; - krijon marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës dhe partnerë në fushën akademike kombëtare dhe ndërkombëtare; - organizon takime dhe leksione të hapura me të ftuar nga fusha e industrisë dhe sipërmarrjes me institucione partnere të KUB; - koordinon mobilitetet e studentëve dhe të stafit akademik; - bashkëpunon me këshillat studentore; - ofron mbështetje për krijimin dhe menaxhimin e infrastrukturës laboratorike në mbështetje të programit të studimit dhe kërkimit shkencor; <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës</i></p> <p><i>Dok. 21.2. Analiza Mësimore Kërkimore DEI 2022-2023</i></p> <p><i>Dok.30.1 Lista e marreveshje te bashkepunimit me partnere kombetare dhe nderkombetare</i></p> <p><i>Dok 38 Lista e personaliteteve te ftuar per Leksione te Hapura ne KUB</i></p> <p><i>Dok. 52. Program i Konferenës Shkencore Studentore</i></p> <p><i>Dok. 30.5. Marrëveshjet me Universitete e huaja për diplomat e dyfishta, Webster University</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nxitja dhe motivimi i studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” për t’u angazhuar në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore gjen zbatim në punimet e temave të diplomave të cilat janë hapi i parë në orientimin e studentëve drejt kërkimit shkencor ose orientimin drejt tregut të punës duke e mbështetur</p>

	<p>në fushat kërkimore shkencore të personelit akademik i cili drejton dhe orienton studentët drejt rezultateve të para të matshme. Dëshmi për këtë është organizimi i konkursit studentor “Projekti im fillon këtu”, ku u përfshinë shumë studentë dhe pedagogë të organizuar nga KUB me stimuj financiarë për fituesit e vendeve të para. Gjithashtu, studentët e KUB nxiten dhe motivohen të marrin pjesë me mobilitete në programet Erasmus+ me partnerë ndërkombëtare dhe të aktivizohen në projektet ku KUB është partner, këtu përmendim: Co Host, RiskMan, Gradua, Kontrabanda e Cigareve dhe përmirësimi i Politikave Fiskale për eliminimin e saj me Kazazi Consultin SHPK, etj. GVJ është i medimit që rezultatet kërkimore dhe bashkëpunimi i studentëve dhe stafit akademik dëshmojnë angazhim të studentëve në mbështetje të pedagogëve dhe kërkimit shkencor brenda institucionit.</p> <p><i>Dok. 27.1. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkuara me partnerët për programin e projekteve në kuader të Erasmus+</i></p> <p><i>Dok. 21.2. Analiza Mësimore Kërkimore DEI 2022-2023</i></p> <p><i>Dok. 29. Raport i projekt aplikimeve në Programe të ndryshme të KUB-it</i></p> <p><i>Dok. 52. Program i Konferencës Shkencore Studentore</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Gjatë takimeve që GVJ pati me Departamentin e Ekonomiksit dhe Informatikës dhe me Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në KUB dhe duke u bazuar në RVB, konstatohet që format e mbështetjes financiare për realizimin e aktiviteteve studimore dhe kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve mbështetet në masën 50% të kostos së saj nga mësimdhënia dhe 50% nga kërkimi shkencor dhe organizimi i konferencave; - Botimi në revista shkecore me faktor impakti dhe SCOPUS financohet 100% nga KUB sipas buxhetit të alokuar me vendim të Bordit të Administrimit;

	<ul style="list-style-type: none"> - 7-8% e totalit të shpenzimeve të KUB shkojnë për mbështetjen financiare të kërkimit shkencor të stafit akademik dhe studentëve; - Të ardhurat e KUB nga projektet përdoren në masën 70% në favor të stafit akademik që përfshihet në realizimin e projekteve; - Buxheti i KUB planifikohet dhe përdoret në nivel departamenti; <p><i>Dok. 27. Rregullore e zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve</i> <i>Dok 39.1 Relacion per realizimin e buxhetit 2022 dhe planifikimin 2023 FE</i> <i>Dok 36.1 Pjesëmarrja e Stafit në Projekte</i> <i>Dok 40 Vendimi i Ba per mbeshtetjen financiare per Kerkimin Shkencor te stafit akademik KUB</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor sipas prioriteteve në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. Për realizimin e aktiviteteve kërkimore e shkencore, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Ekonomisë dhe Informatikës angazhojnë në projekte dhe aktivitete kërkimore stafin akademik dhe studentët duke i ofruar edhe mbështetje financiare nga KUB.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja	Kërkimi shkencor mbështetet nga Departamenti të Ekonomisë dhe Informatikës në bashkëpunim me Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në KUB në përputhje me interesat e institucionit dhe kapacitetet njerëzore, financiare dhe infrastrukturore të

<p>dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>institucionit. Bazuar në Rregulloren e FE, Neni 61, veprimtaritë e kërkimit shkencor realizohen mbi bazën e programeve dhe projekteve të miratuara nga Senati Akademik në përputhje me statutin dhe rregulloret e KUB. Fushat, drejtimet, vëllimi i punës dhe afatet përcaktohen nga Senati Akademik bazuar në fushat prioritare të zhvillimit kombëtar dhe në programit të studimit të ofruara. Stafi akademik dhe çdo student i KUB ka të drejtë të zhvillojë aktivitet kërkimor-shkencor dhe inovativ. Personeli akademik individualisht ose në grup ka të drejtë të aplikojë për mbështetje apo financim nga KUB si edhe organizma të tjerë shtetërore apo privatë për realizimin e projekteve kërkimore-shkencore.</p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 27. Rregullore e zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Nga takimet në institucion dhe nga shqyrtimi i RVB konstatojmë që Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës në bashkëpunim me Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në KUB i përgjigjet kërkesave për analiza e studime që burojnë nga pjesëmarrja si partner në projekte të ndryshme, kërkimore-shkencore apo për ngritje kapacitetesh duke angazhuar personelin e tij akademik dhe studentët për arritjen e objektivave të projekteve.</p> <p><i>Dok. 27.2. Raport mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentët në KUB ne kuader te veprimtarise Erasmus+</i></p> <p><i>Dok. 27.3. Raport i planifikimit të zhvillimit të aktiviteve të KUB nga Marrëveshjet Erasmus +</i></p> <p><i>Dok. 29. Raport i projekt aplikimeve në Programe të ndryshme të KUB-it</i></p> <p><i>Raporti i Vleresimit te Brendshem Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin</p>	<p>Objektivat kërkimorë të Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës realizohen nëpërmjet një numri të konsiderueshëm aktiviteteve shkencore në të cilat angazhohen edhe studentët. Këto aktivitete i shërbejnë kualifikimit të personelit akademik pa grada dhe tituj shkencore për avancimin e tyre drejt një karriere</p>

<p>dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>akademike. KUB organizon konferenca shkencore të përvitshme në të cilat kanë qënë prioritet tematika si: ndërkombëtarizimi i procesit të arsimit, menaxhimi i burimeve të brendshme në përputhje me standardet ndërkombëtare, tematika që lidhen me informatikën, ekonomikë dhe biznesi.</p> <p><i>Dok. 28.3. Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare që janë zhvilluar në KUB përgjatë viteve akademike 2020-2021 , 2021-2022 , 2022-2023</i></p> <p><i>Dok. 28.4. Botime Proceedings të Konferencës së IX-të Shkencore Ndërkombëtare KUB 2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Në vizionin e KUB synohet përgjatitja e profesionistëve për të konkuruar dhe punuar në një treg pune me standarde të larta dhe eksperiencia të përparuara në nivel kombëtar, rajonal dhe ato të Bashkimit Europian, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit duke kontribuar në rritjen e ekonomisë dhe standardeve të demokracisë në vend. Nga evidencat e paraqitura nga institucioni, konstatojmë që studentët e këtij programi punësohen menjëherë në tregun e punës. Gjithashtu, pjesëmarrja e KUB në projektet e mobilitetit Erasmus+ tregon qartë që programet janë konform standardeve ndërkombëtare dhe përputhen me zhvillimet e fundit teknologjike.</p> <p>Studentët që përfundojnë programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” mund të punësohen brenda ose jashtë vendit ose të vazhdojnë karrierën akademike duke vazhduar studimet e doktoratës brenda ose jashtë vendit.</p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. 27.1. Raport i Përfutueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët për programin e projekteve në kuader të Erasmus+</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e</p>	<p>Nuk aplikohet</p>

<p>nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>				
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	Nuk aplikohet			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës në bashkëpunim me Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në KUB mbështesin kërkimin shkencor në përputhje me interesat e institucionit dhe kapacitetet njerëzore, financiare dhe infrastrukturore të institucionit. KUB angazhon stafin akademik dhe studentët në aktivitete të ndryshme shkencore dhe në projektet e mobilitetit Erasmus+ në përputhje me zhvillimet e fundit teknologjike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në KUB, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” zhvillon forma të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminarëve, laboratoreve, praktika profesionale dhe projekt - diploma të miratuara nga IAL bazuar në rregulloret e KUB, FE dhe të programit të studimit. Format e mësimdhënies i prezantohen studentit nga pedagogu i lëndës për secilën lëndë në fillim të semestrit.</p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, por edhe me stafin akademik të angazhuar në këtë program, vërehet një bashkëpunim i ngushtë mes stafit akademik dhe studentëve. Krahas formave tradicionale të mësimin, stafi akademik i programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” tenton të përdorë metoda alternative të mësimdhënies të cilat nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve duke forcuar marrëdhënien pedagog-student si: laboratorët, punët në grupe, prezantimet, orët e hapura, etj.</p> <p>KUB përdor një portal online në mbështetje të procesit të mësimdhënies me anë të të cilit studentët-pedagogët-administrata logohen nëpërmjet adresës elektronike</p>

	<p>institucionale dhe aksesojnë të dhënat të ndryshme të lidhura me profilin e tyre. Konkretisht, në këtë portal, çdo pedagog vë në dispozicion të studentëve të gjithë materialin e lëndës në format elektronik. Institucioni mundëson përshtatjen dinamike të procesit didaktik në bazë të nevojave të studentëve, njohurive të tyre paraprake dhe kushteve të zhvillimit të mësimin. Gjatë periudhës së pandemisë, në kushtet e zhvillimit të mësimin online, KUB ka reaguar menjëherë duke vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik udhëzues/manuale për përdorimin e Google Classroom.</p> <p><i>Dok. 3. Plani i masave të Kolegjit Universitar "I Biznesit", për vitin akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Dok. 62. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme</i></p> <p><i>Dok. 62.2. Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.</p>	<p>Institucioni në tërësi mbështet dhe angazhohet në avancimin akademik të personelit akademik. Një formë e mbështetjes është pjesëmarrja në projekte kërkimore-shkencore apo në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+ për shkëmbim stafi dhe studentësh. Formë tjetër mbështetje është me anë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me biznese në fushën e teknologjisë së informacionit dhe trajnimeve, organizmi i orëve të hapura, pjesëmarrjes dhe referimit në konferenca shkencore dhe publikimit në revista kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Gjatë vizitës në KUB, në takimet me stafin akademik, dekanin dhe përgjegjësin e departamentit, GVJ konstaton që personeli akademik është mbështetur nga IAL në rritjen akademike dhe profesionale dhe është udhëzuar mbi metodat e reja të mësimdhënies innovative. Gjatë takimit me stafin akademik, GVJ u informua që IAL ka vendosur si objektiv për stafin akademik, publikimin e 2 (dy) artikujve shkencorë në vit të cilat do të mbështeten financiarisht nga institucioni.</p> <p><i>Dok 36.1 Pjesëmarrja e Stafit në Projekte</i></p> <p><i>Dok 36.2 Trajnimet e stafit të FE</i></p>

	<p><i>Dok 40 Vendimi i Ba per mbeshtetjen financiare per Kerkimin Shkencor te stafit akademik KUB</i></p> <p><i>Dok. 27.1. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët për programin e projekteve ne kuader te Erasmus+</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Duke iu referuar CV-ve të personelit akademik, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” posedon përgatitjen dhe kompetencat e nevojshme profesionale. Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyre të vazhdueshme. Stafi akademik mbështetet nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnimet dhe pjesëmarrjet në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë, etj. Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se për t’i bërë tërheqëse orët e mësimi, personeli akademik përdor metoda ndërvepruese si puna në grupe, diskutime dhe debate, etj. Për nxitjen e aktivizimit të studentëve, vlerësimi i lëndës është i vazhdueshëm, pra vlerësohet edhe frekuentimi, aktivizimi në aktivitetet mësimore dhe detyrat/projektet lëndore.</p> <p><i>Dok. Shtese - MSC 2021-2022 IB</i> <i>Dok. Shtese - MSC 2022-2023 TI</i> <i>Dok.Shtese - CV stafi angazhuar ne Bch TI, Msc shkenca Informatike</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Rezultatet e pyetësorëve dhe vlerësimeve periodike të studentit për stafin akademik, realizohen nga NJSBC ose nga institucione të jashtme, përfshijnë ndër të tjera edhe format dhe metodat e mësimdhënies. KUB ka zhvilluar mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, që janë rregulluar me rregullorët përkatës për monitorimin e brendshëm të cilësisë dhe raportimi përkatës pranë njësive kryesore dhe bazë. Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet:</p>




	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetësorëve të studentëve për pedagogët dhe programin e studimit 2. Pyetësi drejtuar pedagogeve për kushtet e punës dhe për studentët 3. Intervista me kampion studentësh për çdo program studimi 4. Përshirjen e studenteve në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë. <p><i>Dok 43.3 Format Pyetesori i studenteve KUB</i></p> <p><i>Dok 41 Raporti NJSBC per rezultatet e pyetesoreve ne vitin akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Dok 41.1 Plani i aktiviteteve per permbushje te rezultateve te pyetesoreve ne kuader te permiresimit te standarteve te cilesise Kub</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në bazë të dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni konstatohet se në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik drejtohet nga NJSBC. Kjo njësi ka rregulloren e saj, ku përcaktohet edhe mënyra e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë kryesore dhe bazë. NJSBC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar. Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies në auditor të personelit akademik, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme ku promovohen shembuj të praktikave të mira. KUB është angazhuar në disa projekte ndërkombëtare dhe ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare nëpërmjet të cilave inkurajon dhe stimulon stafin të marrë pjesë në programe shkëmbimi siç janë mobilitetet Erasmus+, KA. Një nga përfitimet kryesore direkte të këtyre shkëmbimeve është përmirësimi i aftësive të personelit akademik në mësimdhënie.</p> <p><i>Dok. 14. Rregullore e zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i></p> <p><i>Dok 41 Raporti NJSBC per rezultatet e pyetesoreve ne vitin akademik 2022-2023</i></p>




	<p><i>Dok. 27.1. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët për programin e projekteve ne kuader te Erasmus+</i></p> <p><i>Dok 41.1 Plani i aktiviteteve per permbushje te rezultateve te pyetsoreve ne kuader te permiresimit te standarteve te cilesise Kub</i></p>			
Konkluzione	<p><i>KUB përdor forma të ndryshme të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive duke iu përgjigjur më së miri larmisë dhe nevojave të studentëve. Stafit akademik i programit të studimit ka përgatitjen dhe kompetencat e nevojshme profesionale dhe impenjohet në përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme. KUB mbështet zhvillimin e metodave të inovative të mësimdhënies dhe trajnimeve të stafit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja..</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren e KUB, Neni 94, Format e Vlerësimit, - Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Neni 47, Format e Vlerësimit - Rregulloren e programit të studimit, Neni 12, Kontrolli i Dijeve dhe Instrumentet e Vlerësimit <p>Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Studenti ka të drejtë të marrë pjesë në provim për vlerësimin e njohurive nëse ka frekuentuar jo më pak se 50% të orëve në auditor të lëndës dhe ka plotësuar në masën 100% detyrimet e punës individuale të</p>

	<p>përcaktuara në syllabusin e lëndës. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të pikëve në masën 40% vlerësim i vazhduar dhe 60% provimi përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar llogaritet si: 10% Pjesëmarrje + 10% Aktivizim + 20% Teste/Detyra kursi.</p> <p><i>Sugjerojmë, që informacionet e cituara në cdo rregullore institucionale, sic është tabela e konvertimit në notë, të sanksionohen vetëm në një rregullore institucionale dhe të referohet ajo rregullore në të gjithë dokumentat e tjerë që e kanë të nevojshëm këtë informacion. Duplikimi i informacioneve, paraqet mundësi të shtuar që informacioni të mbetet i pa azhurnuar në rast ndryshimesh në njërin nga rregulloret.</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit</i> <i>Dok. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FE</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i> <i>Dok. Shtese - MSC 2021-2022 IB</i> <i>Dok. Shtese - MSC 2022-2023 TI</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës, për programet që mbulon, informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve.</p> <p>Format e kontrollit të dijeve janë të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve nga pedagogu i lëndës në javën e parë të procesit mësimor. Studentët informohen rregullisht edhe mbi planet mësimore, kurrikulën e programit të studimit dhe syllabuset nëpërmjet përgjegjësit të departamentit që është njëkohësisht edhe koordinatori i programit të studimit, informacioneve që çdo pedagog publikon në site-in personal në portalin e KUB, faqes zyrtare web të KUB dhe rrjeteve sociale zyrtare të institucionit (facebook, instagram, linkedin)/</p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i> <i>Dok. Shtese - MSC 2021-2022 IB</i> <i>Dok. Shtese - MSC 2022-2023 TI</i> <i>Website i KUB, link: http://kub.edu.al/</i></p>

	<p><i>Facebook IAL KUB, link:</i> https://www.facebook.com/www.kub.edu.al/</p> <p><i>Instagram IAL KUB, link:</i> https://www.instagram.com/kolegji_universitar_i_biznesit/?hl=en</p> <p><i>Linkedin KUB, link:</i> https://www.linkedin.com/in/universitetiibiznesit/</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Vlerësimi i vazhduar, i sanksionuar në rregullore por me mundësinë që të personalizohet nga pedagogu sipas specifikave të lëndë, ka peshën 40% (10% frekuentim + 10% aktivizim + 20% kontroll i ndërmjetëm). Pjesa tjetër, prej 60% e notës, i takon provimit përfundimtar, i cili mund të organizohet me shkrim, me gojë ose me një formë kombinuar, me shkrim dhe me gojë. Disa lëndë aplikative sic janë Programimi dhe Përpunimi i të Dhënave e zhvillojnë testimin dhe vlerësimin e dijeve nëpërmejt aftësive kompjuterike.</p> <p>Në takimin me studentët na konfirmuan që përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin format e veçanta të aftësive dhe talenteve të tyre dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor. Provimi final ose mbrojtja e mikrotezës organizohet në programet master me shkrim nëpërmjet përgatitjes së mikrotezës, procedurë kjo e përcaktuar edhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Dok. Shtese - MSC 2021-2022 IB</i> <i>Dok. Shtese - MSC 2022-2023 TI</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i> <i>Dok 33 Rregullore per zhvillimin e provimeve</i> <i>Dok. 21.2. Analiza Mësimore Kërkimore DEI 2022-2023</i> <i>Dok 33.3 Formular i vleresimit te vazhduar_TIP</i> <i>Dok 33.4 Procesverbal i provimit përfundimtar_TIP</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUB ka të hartuar qartë dhe në detaje në rregulloret institucionale procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve, shqyrtimin e ankimimeve apo nevojave për qartësime të studentëve. Gjithashtu, IAL vlerëson dhe përmirëson periodikisht</i></p>

	<i>format e metodat e mësimdhënies, duke përfshirë në këtë proces studentët dhe stafin akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e KUB, Kreu XII, Kontrolli i dijeve në vecanti Neni 94 - Format e vlerësimit, Neni 95 - E drejta për të hyrë në provime, Neni 96 – Zhvillimi i provimeve, Neni 97 – Shpallja e vlerësimit, Neni 98 – Anikimi i rezultateve të provimit, Neni 99 – Riprovimiet dhe Neni 100 – E drejta për përmirësimin e vlerësimit të lëndës.</p> <p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Vlerësimi i vazhduar, i sanksionuar në rregullore por me mundësinë që të personalizohet nga pedagogu sipas specifikave të lëndëve, ka peshën 40% (10% frekuentim + 10% aktivizim + 20% kontroll i ndërmjetëm). Pjesa tjetër, prej 60% e notës, i takon provimit përfundimtar, i cili mund të organizohet me shkrim, me gojë ose me një formë kombinuar, me shkrim dhe me gojë.</p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit</i> <i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i> <i>Dok 33.3 Formular i vleresimit te vazhduar_TIP</i> <i>Dok 33.4 Procesverbal i provimit perfundimtar_TIP</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të	Vlerësimi në KUB realizohet duke kombinuar provimet me shkrim dhe ato me gojë si dhe format elektronike si prezantimi i detyrave/projekteve të kursit. Për të shmangur abuzimet dhe për të rritur transparencën, sipas Rregullores së Zhvillimit të

<p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Provimeve, Neni 9.6, provimet kryhen të sekretuara. Përfaqësues nga sekretaria asistojnë pedagogun në fillimin e provimit, duke sistemuar studentët në klasë, duke plotësuar listëprezencën dhe duke sekretuar fletët e provimit sipas një kodi unik të caktuar për çdo student. Pas korigjimit të tezave të provimit, sekretaria i jep pedagogut fletën e sekretimit me numrin e tezës dhe emrin e studentit.</p> <p><i>Dok 33 Rregullore per zhvillimin e provimeve</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, u konfirmua se mënyra e vlerësimit të njohurive u bëhet e ditur nga pedagogu i lëndës javën e parë të mësimit. Mënyrat dhe format e vlerësimit janë të paraqitura edhe në syllabusin përkatës të lëndës si dhe në rregulloret institucionale. Provimet zhvillohen sipas kalendarit të provimeve të miratuara dhe shpallura nga dekani i Fakultetit të Ekonomisë jo me vonë se 2 javë para fillimit të sezonit të provimeve.</p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok 33.1 Urdher rektori per miratimin e kalendarit te provimeve</i></p> <p><i>Dok 33 Rregullore per zhvillimin e provimeve</i></p> <p><i>Dok 33.4 Procesverbal i provimit përfundimtar TIP</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i komponentëve të vlerësimit përfundimtar shoqërohet me komente nga pedagogu/pedagogët e lëndës, ku qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin. Korigjimi i provimit shoqërohet me komente në lidhje me gjetjet e pedagogut dhe arsyetimin e vlerësimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit u konstatua që në rastet e nevojshme, pedagogu/pedagogët e lëndës janë të gatshëm të japin mbështetjen dhe sqarimet shtesë të nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë.</p>

	<p><i>Dok 33 Rregullore per zhvillimin e provimeve</i></p> <p><i>Dok 33.4 Procesverbal i provimit perfundimtar_TIP</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik për shmangien e plagjiaturës, kopjimin në provime dhe detyra, bazohen në Rregulloren e Zhvillimit të Provimeve dhe Kodit të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiature gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike. Për këto të fundit, përgjegjësinë kryesore për vlerësimin dhe shmangien e plagjiaturës e ka pedagogu udhëheqës. Detyrat e kursit zakonisht dorëzohen në hard-copy dhe prezantohen me gojë individualisht apo në grup në varësi të kërkesës së pedagogut. Për përgatitjen e temave të diplomave zbatohet udhëzuesi për punimin e diplomës me të gjitha kriteret dhe standardet e caktuara nga KUB në rregulloret e saj. Disa nga masat parandaluese që përdor stafi akademik apo të cilat IAL i parashikon në Rregulloren e zhvillimit të provimeve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provimet zhvillohen në auditor nën monitorimin e pedagogut të lëndës; - Përdorimi i celularit nuk është i lejuar në sallën e provimit; - Studenti duhet të paraqitet në provim me mjet identifikimi; - Tezat e provimit hartohen para çdo provimi dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit; - Detyrat e kursit dhe projektet dorëzohen me shkrim dhe mbrohen me gojë; <p>Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë.</p> <p>Duke patur parasysh avancimet e shpejta teknologjike në fushën e Inteligjencës Artificiale dhe përdorimit në masë të mjeteve për gjenerim inteligjent të tekstit, <i>GVJ sugjeron që institucioni të shikojë mundësinë e parashikimit në buxhetin e tij të një software të licensuar për kontroll të plagjiaturës dhe</i></p>

	<p><i>të identifikimit të tekstit të gjeneruar nëpërmjet AI. Kjo do të ndihmonte jo vetëm në ruajtjen e etikës profesionale në kërkimin shkencor por edhe në rritjen e cilësisë së punimeve të studentëve dhe stafit akademik.</i></p> <p>Dok 33 Rregullore per zhvillimin e provimeve Dok 33.4 Procesverbal i provimit perfundimtar_TIP Dok. 60. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Teza e provimit përfundimtar është 60 pikë, ndërsa 40 pikë fitohen gjatë vitit nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm. Studentëve u bëhet i ditur nga pedagogu rezultati i fituar nga kontrollit të vazhdueshëm veçmas për secilin element vlerësues dhe në totalin e tyre para hyrjes në provimin përfundimtar. Vlerësimi konvertohet me bazë notash nga 1 në 10. Nota më e ulët kaluese është nota 5. Sipas rregullores, rezultatet e provimit hidhen në portal nga sekretaria mësimore jo me vonë se 1 javë nga data e zhvillimit të provimit përfundimtar. Studenti ka të drejtë të sqarohet nga pedagogu i lëndës në lidhje me vlerësimin ose të ankimohet brenda 72 orësh nga shpallja e rezultatit të provimit sipas rregulloreve institucionale.</p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FE Dok 33 Rregullore per zhvillimin e provimeve Dok. 46. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar takimit me studentët, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim të rezultatit të provimit sikurse është e përcaktuar edhe në rregulloren për zhvillimin e provimeve. Mbas shpalljes së rezultateve nga pedagogu, studenti ka të drejtën e ankimit brenda 72 orësh. Kërkesa e studentëve për rivlerësim dorëzohet në sekretari dhe i drejtohet pedagogut të lëndës i cili rivlerëson edhe njëherë provimin brenda 1 (një) jave në prani të studentit. Studentët që përsëri nuk janë dakord me vlerësimin, kanë të drejtë të përshkallëzojnë ankesën duke iu drejtuar dekanit brenda 3 (tre) ditësh. Dekani e përcjell ankesën në departamentin përgjegjës për programin e studimit dhe është përgjegjësi i departamentit i cili ngre një komision ad-hoc. Ky komision merr vendim të formës së prerë në lidhje me rezultatin final të provimit brenda 5(pesë) ditësh dhe ia</p>

	<p>përcjell këtë informacion sekretarisë, e cila njofton studentët. Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, u vu re se në përgjithësi ata merrnin përgjigje rreth çdo paqartësie të mundshme direkt me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre. Studentët vunë në duke disponibilitetin e pedagogëve për sqarime dhe këshillime të studentëve.</p> <p><i>GVJ sugjeron IAL të rishikojë Rregulloren e KUB, Neni 98 dhe Rregulloren për Zhvillimin e Provimeve, Neni 16.3 në mënyrë që procedurat të jenë më të qarta dhe të kuptueshme për studentët. Konkretisht, në rregulloren e KUB parashikohet ankimim drejtuar pedagogut në lidhje me provimin dhe me tej përshkallëzimi i ankimimit drejtuar Dekanit, ndërsa Rregullorja për Zhvillimin e provimeve parashikon që ankimi i drejtohet Pergjegjësit të Departamentit.</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit Dok 33 Rregullore per zhvillimin e provimeve</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Të drejtat e studentit janë të përcaktuara në rregulloret institucionale të cilat kanë të përcaktuara të gjitha hallkat dhe mënyrat se si dhe kur studenti duhet të kryej një ankesë, si shqyrtohet ajo dhe mënyra e informimit. Gjatë vizitës në institucion nuk u vu re një praktikë konkrete pasi studentët nuk kishin patur ankesa që të kërkonin përshkallëzime në procesin e ankimimit.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUB siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Institucioni ka të hartuar në rregulloret institucionale të gjitha procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e ankimimeve apo nevojave për qartësime të studentëve.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>IAL të shohë mundësinë që të kontrollojë mikrotezat e diplomave master shkencor me një sistem të licencuar për antiplagjiaturë dhe detektim të tekstit të gjeneruar me anë të AI.</i>




	– Saktësimin e procesit të përshkallëzimit të ankimimit në Rregulloren e KUB dhe në Rregulloren për Zhvillimin e Provimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin në mënyrë të balancuar lëndë në dy fusha: informatikë dhe ekonomi. Në përmbyllje të studimeve zhvillohet praktikë profesionale dhe punimi i diplomës. Ky program synon t'i përgatisë studentët me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në formimin teorik dhe kërkimin shkencor për të siguruar formimin e specialistëve të lartë informaticienë biznesi dhe specialistë të lartë në fushën e E-commerce dhe Inovacion. Programi bazohet në kërkesat aktuale të tregut të punës, konkretisht nëpërmjet moduleve që kanë në qendër thellimin e njohurive në gjuhët e programimit, sistemeve të informacionit, sigurisë, dizenjimin e bazave të të dhënave si edhe analizën dhe përpunimin e tyre. Gjithashtu, në këtë program studimi është parashikuar lënda “Praktikë/stazh 3 mujor”, e cila synon që të aftësojë studentin të aplikojë në praktikë njohuritë e përfuara gjatë studimeve në një ambient real në tregun e punës. Stafi akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare.</p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në	Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” garanton

<p>fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>zhvillimin e veçantë në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe të aftësive specifike në fushën ekonomike, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit.</p> <p>Për sa më sipër, në planin mësimor të këtij programi studimi, janë të parashikuara zhvillimi i lëndëve karakterizuese multidisiplinare në teknologjinë e informacionit dhe ekonomi si: Programim i avancuar, data mining, Sisteme të përpunimit të informacionit, siguria e sistemeve të informacionit, administrim baze të dhënash, drejtim financiar i avancuar, qeverisje korporatash, menaxhim i integruar i projekteve, tregjet dhe institucionet financiare, etj. Këto lëndë së bashku me të tjera zhvillojnë aftësitë profesionale të veçanta të studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit, rezulton se në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës, rezultatet e pritshme dhe mënyrat e vlerësimit. Metodot e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale analizohen dhe vlerësohen në përfundim të lëndës. Në këtë mënyrë u evidentohen studentëve konceptet dhe çështjet më të rëndësishme të lëndës, si dhe detyrimet përmbyllëse dhe vlerësimi i tyre sipas kriterëve të parashikuara dhe prezantuar në syllabuset e lëndëve. GVJ u informua gjatë takimit me stafin akademik se nga ana e tyre studentët mbështeten, orientohen dhe udhëzohen në mënyrë të vazhdueshme për realizimin e detyrave e projekteve të caktuara si punë individuale apo në grup.</p> <p>Çdo pedagog, në përfundim të procesit mësimor (në javën e fundit të semestrit), bën një analizë dhe përmbledhje të të gjithë procesit të realizuar me studentët, duke evidentuar çështjet më të rëndësishme dhe kompetencat e fituara që studentët duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe</p>




	<p>gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.</p> <p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në "Shkenca Informatike"</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i> <i>Dok.Shtese - MSC 2021-2022 IB</i> <i>Dok.Shtese - MSC 2022-2023 TI</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Institucioni garanton akses në 2 (dy) laboratorët e informatikës për studentët e këtij programi studimi. Edhe pse në plan-programet e lëndëve nuk është e parashikuar aktiviteti laboratorik, gjatë takimit në institucion dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi u konfirmua zhvillimi i lëndëve, kryesisht i seminareve, në ambiente të pajisura me PC, ku zhvillohen edhe aplikimet praktike në simulime, programim etj. Edhe nga stafi akademik, u vu në dukje, se zhvillimi i seancave laboratorike është i gërshetuar me ato teorike. Staf i akademik i njësisë bazë angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca, simpoziume dhe workshope, si dhe mundëson zhvillimin e orëve të hapura nga pedagogë të ftuar pranë këtij institucioni. Personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Kjo u vu në dukje edhe gjatë takimit me studentët të cilët cilësuan si pikë të fortë të institucionit komunikimin me pedagogët dhe mbështetjen në përfshirjen e tyre në aktivitete akademike jashtë-kurrikulare (seminare, konferenca, projekte, internshipe, etj). Detyrat/projektet e kursit vlerësohen nga studentët si një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup dhe zgjidhjen e problemeve të zbatimit real. Në të njëjtën kohë KUB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi me IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet.</p>




	<p><i>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike”</i></p> <p><i>Dok. 28.2. Raporti Vjetor i Punës Kërkimore Shkencore dhe Projektet, Kolegjit Universitar “I Biznesit”</i></p> <p><i>Dok. 28.3. Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare që janë zhvilluar në KUB përgjatë viteve akademike 2020-2021 , 2021-2022 , 2022-2023</i></p> <p><i>Dok. 27.2. Raport mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentët në KUB si dhe me përfaqesues te IAL partnere ne kuader te ERASMUS+</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i KUB harton metoda interaktive gjatë vitit akademik për të transmetuar njohuritë tek studentët. Shumica e pedagogëve zhvillojnë leksione, orë praktike, dhe praktika mësimore në qendra dhe biznese partnere, si dhe leksione të hapura, për të siguruar që studentët të përvetësojnë njohuritë në mënyrë sa më efektive. Këto orë mund të drejtohen nga stafi akademik (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. jashtë strukturës së programit të studimit dhe në orare që nuk bien ndesh me procesin mësimor.</p> <p><i>Dok. 28.1. Plan i Veprimtarive Akademike e Shkencore 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur në DVV dhe nga vizita në institucion, konstatohet se IAL inkurajon zhvillimin e ideve inovative të stafit akademik dhe studentëve të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. KUB iu krijon studentëve mundësi për përfshirje në projekte kërkimore nëpërmjet projekteve ndërkombëtare ku KUB merr pjesë apo nëpërmjet programeve të mobiliteteve Erasmus+. Punimet e përzgjedhura të diplomave Master Shkencor në KUB shpesh janë prezantuar në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare edhe me mbështetje financiare nga institucioni. Kolegji Universitar i Biznesit në bashkëpunim me Qeverinë Studentore të KUB si edhe tre njësitë e tij kryesore, Fakultetin e Ekonomisë, Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Politike dhe Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale organizojnë çdo vit Konferencën Kombëtare Studentore.</p>

	<p>GVJ e vlerëson këtë si një praktikë të mirë që krijon hapësira për studentët për të diskutuar dhe paraqitur punimet e tyre duke shprehur risitë dhe idetë e reja që ata sjellin.</p> <p><i>Dok. 51. Program Konferencë Shkencore</i></p> <p><i>Dok. 52. Program i Konferencës Shkencore Studentore</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës me mbështetjen e Fakultetit të Ekonomisë në KUB për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion", janë të angazhuar në rritjen e cilësisë në tërësi të ofertës akademike duke realizuar në mënyrë të vazhduar konferenca studentore, takime, seminare, workshop-e, në kuadër të bashkëpunimeve dhe në motivimin e studentëve drejt tregut të punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>KUB parashikon procesin e diplomimit të studentëve në tërësi në aktet e brendshme rregullatore. Rregullorja e njësisë kryesore dhe ajo e njësisë bazë paraqesin qartë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në këtë program studimi. Mbrojtja e diplomës realizohet me temë diplome dhe vlerësohet me notë dhe studenti fiton kreditet përkatëse sipas planit mësimor bazuar në rregulloren e programit të studimit, Neni 18, pika 3. IAL ka vënë në dispozicion të studentëve edhe paketën udhëzuese për mbrojtjen e diplomës. Departamenti shpall sipas afateve në kalendarin akademik temat orientuese për mbrojtjen e diplomës. Studentët që plotësojnë kriteret për diplomim, pasi kanë rënë dakord paraprakisht me udhëheqësin, paraqesin</p>

	<p>kërkesën e tyre në sekretari, të firmosur edhe nga udhëheqësi. Drejtuesit e temave të diplomave miratohen nga Dekani.</p> <p>Pedagogët punojnë me studentët, i orientojnë, i ndihmojnë të punojnë në mënyrë të pavarur dhe ndajnë materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kryesisht kërkimore. Tema e përfunduar dhe e firmosur edhe nga udhëheqësi dorëzohet fizikisht dhe me pas studenti bën mbrojtjen me prezantim para një komisioni të propozuar nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe të miratuar nga Dekani. Komisioni i diplomës bën vlerësimin e studentëve dhe plotëson procesverbalin përkatës.</p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i> <i>Dok. 60. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë</i> <i>Dok. 59. Urdhër për ngritjen e komisionit të provimit për mbrojtje diplome</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit akademik, përfshirë edhe diplomimin e studentëve, është Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës. Kjo njësi, në bashkëpunim me të gjithë stafin akademik, harton një listë orientuese temash të cilat mund të zgjidhen nga studentët. Njësia bazë përgatit një paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës, material i cili disponohet edhe nga sekretaria mësimore dhe u vihet në dispozicion studentëve. Studentët zgjedhin ose u caktohet me konsensus një pedagog udhëheqës i cili i ofron ndihmë dhe i orienton, i bën vërejtje dhe i udhëzon deri në realizimin përfundimtar të punimit dhe dorëzimin e tij.</p> <p>Gjithashtu, të gjitha njoftimet në lidhje me detyrimet përmbyllëse afishohen në një kënd të posaçëm në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë, publikohen online në faqen zyrtare të institucionit dhe u dërgohen me email studentëve. Datat e provimeve dhe mbrojtjeve të diplomave publikohen edhe në rrjetet sociale të KUB.</p> <p><i>Dok. 60. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë</i> <i>Dok. 55. Udhëzues për përgatitjen e Praktikës Profesionale</i></p>




<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, Neni 18, diploma në përfundim të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” mbrohet me temë diplome. Tema e diplomës vlerësohet me notë dhe me kredite sipas planit mësimor. Studenti ka të drejtën e zgjedhjes së një udhëheqësi nga pedagogët sipas përcaktimeve të drejtuesit të njësisë bazë. Tema e përfunduar dhe e firmosur edhe nga udhëheqësi dorëzohet fizikisht dhe më pas studenti bën mbrojtjen me prezantim para një komisioni të propozuar nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe të miratuar nga Dekani. Komisioni i diplomës bën vlerësimin e studentëve dhe plotëson procesverbalin përkatës.</p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”, Neni 18</i> <i>Dok. 60. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tezës së diplomës. Në këtë proces, KUB vë në dispozicion të gjithë bazën laboratorike që disponon, ambientet e laboratorit, bibliotekës madje u mundëson studentëve edhe internshipe në kompanitë partnere të cilat disponojnë infrastrukturë mbështetëse për zhvillimin e temës specifike të diplomës. Pedagogu udhëheqës i punimit të diplomës së studentit ka rol kyç në vlerësimin cilësor të punimit. Studenti fiton të drejtën e mbrojtjes së punimit përpara komisionit, pasi është marrë miratimi i udhëheqësit i cili ka rol këshillues/udhëzues për studentin në realizimin e punimit të diplomës. Punimet e diplomave ruhen në sekretarinë mësimore të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”, Neni 18</i> <i>Dok. 60. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit si dhe në udhëzuesin për përgatitjen e diplomës, për këtë program</p>

<p>matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>studimi, punimi i diplomës jo domosdoshmërisht duhet të ketë punim praktik, në rastet kur tema përfshin një fushë të tillë departamenti mbështet realizimin e punimit praktik të temës së diplomës. Mbështetja përfshin edhe vënien në dispozicion të studentit të ambienteve laboratorike nëse është e nevojshme. Institucioni vendos në dispozicion të studentëve në tërësi, edhe fondin e bibliotekës fizike dhe online dhe u mundëson studentëve edhe internshipe në kompanitë partnere me të cilat ka marrëveshje në rastin kur infrastruktura mbështetëse për zhvillimin e temës specifike të diplomës disponohet nga këto kompani.</p> <p>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”, Neni 18 Dok. 60. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i vlerësimit përfundimtar përbëhet nga të paktën 3 (tre) anëtarë të propozuar nga Dekani dhe miratuar nga Rektori i KUB. Punimi i diplomës në planin mësimor është i caktuar me 18 kredite ECTS dhe vlerësohet me notë, njësoj si çdo lëndë tjetër e këtij programi studimi. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjithë anëtarëve të komisionit dhe i bëhet e ditur studentëve ditën e mbrojtjes së temës ose një ditë më pas nga sekretaria mësimore.</p> <p>Dok. 15. Dosja e Programit të Studimit MSc në “Shkenca Informatike” Dok. 60. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, institucioni i pajis studentët me diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës sipas formës së miratuar dhe të regjistruar në QSHA (Qendra e Shërbimeve Arsimore). Modelet e diplomës për çdo program studimi të Fakultetit të Ekonomisë janë miratuar nga Senati Akademik i KUB. Ky program studimi, sapo ka diplomuar brezin e parë të studentëve dhe do të regjistrojë diplomat dhe suplementet në përputhje me udhëzimet përkatëse të MAS.</p>




	<p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. 23. Model Diplome MSc në "Shkenca Informatike"</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstojmë së të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi dhe janë në çdo moment në dispozicion të sekretarisë mësimore. Dosja e studentit arkivohet në arkivën e KUB në momentin që studenti diplomohet/çregjistrohet/transferohet. Në rastin e studentëve të diplomuar në KUB, dosjes së studentit i bashkangjitet edhe një fotokopje e diplomës dhe suplementit. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, vihet re një organizim i arkivës dhe i materialeve për çdo student, lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë në çdo moment. Kjo procedurë lehtëson punën e sekretarisë mësimore për hartimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të kërkohen nga studentët apo ish studentët në çdo kohë.</p> <p><i>Dok.10 Rregullore e Zyres se Arkivit</i></p> <p><i>Dok 46 Rreg e sekretarisë mesimore</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUB ka të përcaktuar qartë procedurat e përfundimit të studimeve dhe të mbrojtjes së diplomës. KUB pajis studentët me diplomën dhe suplementin e diplomës sipas standardeve të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion", sapo ka diplomuar brezin e parë të studentëve dhe do të regjistrojë diplomat dhe suplementet në përputhje me udhëzimet përkatëse të MAS.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfuturit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk Aplikohet
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nuk Aplikohet
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informatike” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” ofrohet nga KUB sipas nivelit 7 në kornizën kombëtare të kualifikimeve.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, institucioni ka angazhuar stafin akademik me kualifikimet si më poshtë:				
	Kualifikimi i stafit të angazhuar në mësimdhënie	2021-2022		2022-2023	
		PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof. Dr	1	0	1	0
	Prof. Asoc.	0	1	1	0
	Dr/Phd	3	2	4	3
	Dr në proces	0	1	0	0
	Msc.	1	0	2	0
Gjithsej	5	4	8	3	
Bazuar në tabelën e mësipërme konstatojmë si më poshtë vijon:					

	<table border="1"> <tr> <td>Stafi akademik i angazhuar në programin studimit</td> <td>Viti akademik 2021-2022</td> <td>Viti akademik 2022-2023</td> </tr> <tr> <td>Me Msc</td> <td>22% (2/9)</td> <td>18% (2/11)</td> </tr> <tr> <td>Me kontratë</td> <td>44% (4/9)</td> <td>27% (3/11)</td> </tr> </table> <p>GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për të ulur numrin e stafit akademik me kontratë të angazhuar në programin e studimit dhe <u>sugjeron që IAL të marrë masa sipas ligjit të angazhojë në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" staf akademik me të paktën gradën shkencore "Doktor".</u></p> <p>GVJ vë në dukje që stafi akademik me gradën shkencore Master i Shkencave nuk mund të angazhohet në mësimdhënie në programe studimi Master Shkencor.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" zhvillon për herë të parë procesin e akreditimit në nivel programi studimi.</p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI; Tabela 6.1; Tabela 6.2</i></p> <p><i>CV stafi angazhuar ne Bch TI, Msc shkenca Informatike;</i></p>	Stafi akademik i angazhuar në programin studimit	Viti akademik 2021-2022	Viti akademik 2022-2023	Me Msc	22% (2/9)	18% (2/11)	Me kontratë	44% (4/9)	27% (3/11)						
Stafi akademik i angazhuar në programin studimit	Viti akademik 2021-2022	Viti akademik 2022-2023														
Me Msc	22% (2/9)	18% (2/11)														
Me kontratë	44% (4/9)	27% (3/11)														
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e orëve mësimore për dy vite akademike është si më poshtë :</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021-2022</td> <td>600</td> <td>360</td> <td>240</td> <td>60 % / 40%</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>1200</td> <td>810</td> <td>390</td> <td>67.5% / 32.5%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Bazuar në evidencën tabelat përmbledhëse (tabelat 12.1, 12.2) për dy vitet akademike 2021-2022 dhe 2022-2023,</p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2021-2022	600	360	240	60 % / 40%	2022-2023	1200	810	390	67.5% / 32.5%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)												
2021-2022	600	360	240	60 % / 40%												
2022-2023	1200	810	390	67.5% / 32.5%												

	<p><i>GVJ konsaton që ngarkesa mësimore nuk është realizuar në masën 70 % nga personeli akademik efektiv (PAE), sipas ligjit në fuqi.</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI Tabela 12.1, 12.2</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ konstaton se në vitet e fundit ka patur qëndrueshmëri të personelit akademik me kategorinë Lektor të angazhuar në programin e studimit. Nga takimet me përfaqësues të sektorit të Burimeve Njerëzore GVJ u informua se personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në programin e studimit lidh kontratë pune me afat të caktuar për kategorinë Asistent Lektor dhe me afat të pacaktuar për kategorinë Lektor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Si institucion publik, KUB garanton dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik të punësuar. Personeli akademik me kontratë angazhohet mbi bazën e kontratave vjetore ose semestrale.</p> <p><i>Takim me zyrën e Burimeve Njerëzore në Institucion;</i></p> <p><i>Dok. 32.1. Kontrate Pune FT_TIP;</i></p> <p><i>Dok. 32.2. Kontrate Pune PT_TIP;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar i Biznesit ka përcaktuar në Statutin e tij dhe Rregulloren e Marrëdhënieve të Punës procedurat për rekrutimin e personelit në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, VKM për stafet akademike, Kodi i Punës, aktet nënligjore të MAS. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të rekrutimit të personelit. GVJ verifikoi se kuadri rregullativ i KUB përmban procedura transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit të personelit. Kjo mënyrë siguron që kandidatët të plotësojnë kushtet dhe të jenë në nivelin e duhur të kualifikimeve në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>Dok. 1. Statuti i KUB, kreu 5, neni 41-53;</i></p> <p><i>Dok.12 Rregullore e Marredhenieve te Punes ne KUB;</i></p> <p><i>Dok. 32.3. Një praktikë e rekrutimit të stafit akademik në KUB;</i></p>




	<i>Takim me zyrën e Burimeve Njerëzore në Institucion;</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Gjatë vizitës në KUB, GVJ konstatoi se vetë stafi akademik efektiv i institucionit, mbështet realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorike në mbështetje të procesit mesimor. Gjithashtu, (dy) anëtarë të stafit akademik angazhohen në mirëmbajtjen e laboratorëve dhe përditësimin e infrastrukturës softwarike.</p> <p><i>GVJ sugjeron: për mbështetjen e stafit akademik dhe studentëve në zhvillimin dhe realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorëve të angazhohet personelit ndihmës-akademik i dedikuar.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	<p>Zyrat përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ, në KUB, është Zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkivit (ZBNjAA). GVJ zhvilloi takim me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore. GVJ konstatoi se kjo zyrë bashkërendon punën e saj me njësitë bazë në fakultete në lidhje me përditësimin e të dhënave të stafit akademik. Sipas RVB, çdo vit përditësohen CV e pedagogëve të cilat gjenden dhe në site-n personal të çdo pedagogu, ku pasqyrohen veprimtaritë kërkimore, publikimet dhe konferencat shkencore ku ai/ajo merr pjesë. ZBNjAA administron gjithashtu dhe formularët e vlerësimit të performancës.</p> <p><i>Dok. 70. Përmbajtja e dosjes së stafit akademik FTPT</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike</i></p>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen	<p>KUB ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në rang kolegji. Lista e këtyre marrëveshjeve me universitete kombëtare/ndërkombëtare institucione ose kompani mund të gjendet në websitin e KUB https://kub.edu.al/partneret/ KUB, në kuadrin e zbatimit të marrëveshjeve me subjekte të ndryshme private dhe organizata/institucione të tjera, përcakton staf akademik për të ndjekur nga afër studentët në praktikën profesionale dhe punimin e diplomës.</p>

<p>e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p><i>Dok. 68. Urdhër dekani për ndjekjen e praktikave mësimore</i></p> <p><i>Dok. 30.1. Lista e marrëveshje të bashkëpunimi me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë</i></p> <p><i>https://kub.edu.al/partneret/</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI Tabela 4</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe në ndjekje të udhëzuesit për përgatitjen e praktikave profesionale drejtuesit e bizneseve, japin udhëzime me vlerë për studentët në kuadër të praktikës profesionale, bëjnë rekomandime dhe vlerësime, duke plotësuar formularët e dërguar nga ana e KUB për ndjekjen e zhvillimin e praktikës nga studentët.</p> <p>Në përfundim të praktikës profesionale përfaqësuesi i kompanisë ku kryhet praktika profesionale, përgatit një vlerësim për punën e kryer nga studenti gjatë praktikës profesionale. Ky vlerësim konsiderohet edhe nga komisioni i mbrojtjes së praktikës për studentin përkatës.</p> <p><i>Dok. 55. Udhëzues për përgatitjen e Praktikës Profesionale;</i></p> <p><i>Dok.30.4 Model Marrëveshje TIP KUB me IAL, Biznes, Siper marrje, OJF etj</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Jo i gjithë personeli akademik, i angazhuar në programin Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor. Fusha kërkimore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve.</i> - <i>Ngarkesa mësimore nuk realizohet në masën 70 % nga personeli akademik efektiv.</i> - <i>Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të mirëpërcaktuara dhe të pasqyruara në aktet rregullatore të KUB.</i> <p><i>GVJ sugjeron që IAL të marrë masa për të mos angazhuar staf akademik me gradën shkencore Master i Shkencave në</i></p>

	<i>programin e studimit dhe të bëjë të mundur që PAE të mbulojë minimumi 70% të ngarkesës së planit mësimor.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Për realizimin e procesit mësimor, në KUB, janë vënë në dispozicion ambientet e duhura për zhvillimin si të leksioneve e seminareve ashtu edhe të seanceve laboratorike për programin e studimit. Në dispozicion të tij janë dy laboratorë me kompjutera. Nga vizita në mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor, GVJ konstatoi se ato janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira, ndërsa laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar software e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor. Institucioni ka 1 sallë aktivitete promovuese dhe 1 sallë për praktikë lëndore/profesionale si dhe zyra për stafin si dhe bibliotekën dhe 1 zyrë informacioni për studentë.</p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI Tabela 16</i></p> <p><i>Dok shtesë: Inventari i pasisjeve laboratorike</i></p> <p><i>Vizita GVJ në Institucion</i></p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit	Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion të realizimit të këtij programi studimi. KUB zotëron 2 laboratorë informatike të pajisur me teknologjitë e nevojshme për të realizuar procesin mësimor si dhe praktikat mësimore për lëndë të këtij profili. Gjithashtu, mjediset e zhvillimit të procesit mësimor janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, videoprojektor, si mundësi aksesimi të internetit

<p>mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>(lidhje wireless), etj. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar. Ambjentet janë të pajisura me banka dhe karrige komode për t'ju përgjigjur edhe qëndrimit me orë të zgjatura në leksione dhe seminare të studentëve.</p> <p><i>Vizita GVJ në Institucion</i></p> <p><i>Dok shtesë: Inventari i pasisjeve laboratorike</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>KUB për lëndët dhe programet e Informatikës ka infrastrukturë të përshtatshme teknologjike me 2 laboratorë kompjuterash. Të gjithë kompjuterat janë me parametra të lartë teknike dhe programe të nevojshme për lëndët. GVJ është e mendimit se kjo infrastrukturë informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><i>Vizita GVJ në Institucion</i></p> <p><i>Dok shtesë: Inventari i pasisjeve laboratorike</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Laboratorët e informatikës, janë të pajisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementë e tij përbërës. Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit akademik me kualifikimin e duhur.</p> <p><i>Vizita GVJ në Institucion</i></p> <p><i>Dok shtesë: Inventari i pasisjeve laboratorike</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme</p>	<p>Praktikat profesionale, e integruar dhe e mësimdhënies për degën e Master në KUB ka shumë marrëveshje bashkëpunimi me bizneset, të cilat në periudhën e fillimit të praktikave profesionale presin, sistemojnë studentët e programit të studimit dhe angazhohen për plotësimin e planit të praktikës së tyre sipas udhëzimit të posaçëm të miratuar në senatin e KUB dhe dosjes së dokumentave të praktikës. Në përfundim të praktikës plotësohet edhe raporti i praktikës së studentit dhe vlerësimi përkates, i cili kërkohet dhe shërben për vlerësimin e studentit nga komisioni i pedagogëve të KUB për mbrojtjen e praktikës.</p>

<p>për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulate me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Elementë praktikë të përvetësimit të lëndëve shfaqen në kuadër të realizimit të programit përkatës si dhe në kuadër të temës së diplomës.</p> <p><i>Vizita GVJ në Institucion</i></p> <p><i>Dok shtesë: Inventari i pasisjeve laboratorike</i></p> <p><i>Dok.55. Udhëzues për përgatitjen e Praktikës Profesionale.</i></p> <p><i>Dok. 68. Urdhër dekani për ndjekjen e praktikave mësimore</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira. Laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar software e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor.</i> - <i>Infrastruktura informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</i> - <i>Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit akademik me kualifikimin e duhur.</i> <p><i>GVJ vlerëson se KUB ka vënë në dispozicion të programit të studimit mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në</p>	<p>Një pjesë e konsiderueshme e literaturës bazë dhe ndihmëse, në format fizik dhe digjital, ndodhet në bibliotekën e KUB, në hapësirën e dedikuar fushës së shkencave informatike në mënyrë</p>




<p>gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>që studentët të mund të kenë akses të menjëhershëm sipas nevojave. GVJ u informua se literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme për vetë veçantinë e këtij programi janë kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht). Në rastet kur moduli nuk ka patur një libër të botuar në gjuhën shqipe stafi është angazhuar në përgatitjen e cikleve të leksioneve të cilat i janë vënë në dispozicion studentëve duke u depozituar në librarinë e KUB.</p> <p><i>Dok. 67.4. Model përmbledhje Cikël Leksioni nga libreria e KUB</i></p> <p><i>Dok. 67.2. Lista e teksteve të reja për programin e studimit MSc në "Shkenca Informatike"</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>KUB i kushton rëndësi përditësimit të literaturës. Sipas raportit vjetor të veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB 2021-2022 në vitin 2022 buxheti për bibliotekat parashikonte si burime financiare të nevojshme rreth 300 mijë lekë, për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj të autorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.</p> <p><i>Doc. 20. Annual Report of Academic and Financial Activity of UCB 2021-2022</i></p> <p><i>Dok. 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022</i></p> <p><i>Dok. 67.2. Lista e teksteve të reja për programin e studimit MSc në "Shkenca Informatike"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e KUB, është e konceptuar dhe e implementuar në hapësirë me 80 poste leximi dhe e pajisur me laptopë me akses në internet. Në bibliotekë gjenden 7150 tituj në gjuhë shqipe dhe të huaj, në formatin letër. Fondi shqip dhe i huaj mbulon të gjithë fakultetet e kolegjit. Literatura është bashkëkohore, kryesisht shkencore me moshë mesatare 5-10 vjeçare. Biblioteka është e abonuar në revista shkencore on-line duke lejuar aksesimin e informacioneve të pasura dhe bashkëkohore. Ndër këto përmendim JSTOR, Academia, GSTORE: ebiblioteka:</p>

	<p>https://www.jstor.org/ ; Academia.edu, https://www.academia.edu/; Gstore https://www.gstore.com</p> <p>Gjithashtu studentët informohen mbi adresat e bibliotekave online që janë falas:</p> <p>http://www.ebrary.com/corp/;</p> <p>https://www.ebsco.com/public-libraries;</p> <p>https://www.thefreelibrary.com/;</p> <p>https://www.gutenberg.org/;</p> <p>https://www.acm.org/;</p> <p>https://al.cobiss.net/;</p> <p>http://www.readprint.com/</p> <p><i>Dok 67.1 Relacion i bibliotekes KUB</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e KUB është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme.</p> <p>Ne vërejmë se Biblioteka mbulon të gjitha modulet e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Në bibliotekë studentët mund të gjejnë në format fizik dhe elektronik edhe leksionet e çdo lëndë nga pedagogët përkatës. Në ndihmë të studentëve janë dhe bibliotekat on-line të cilat mundësojnë të sigurohet akses në një literaturë të gjerë dhe të përditësuar në gjuhë të huaj, kryesisht në gjuhën angleze dhe studentët preferojnë këtë opsion.</p> <p><i>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</i></p> <p><i>Dok 67.1 Relacion i bibliotekes KUB</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>KUB ka akses në bibliotekën digjitale JSTOR e cila ofron më se 12 milionë artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe mbi 2 milion dokumente në 75 disiplina. JSTOR është e aksesueshme nga studentët dhe stafi akademik. Biblioteka është e abonuar dhe në revista të tjera shkencore on-line. Ndër këto përmendim Academia, GSTORE: ebiblioteka:</p>

	<p>https://www.jstor.org/; Academia.edu, https://www.gstore.com</p> <p>GVJ në vizitën e tij në Bibliotekë, konsaton se studentët dhe pedagogët kanë akses të barabartë e pa pagesë në bibliotekën digjitale online, që siguron qasje në revista akademike, libra dhe burime kryesore. Çdo student e pedagog ka të drejtë anëtarësimi falas në bibliotekë.</p> <p><i>Dok 67.1 Relacion i bibliotekes KUB</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ konsaton se Biblioteka është e pajisur me poste leximi dhe pajisje kompjuterike, për ofrimin dhe aksesimin në bibliotekën digjitale të kolegjit dhe të bibliotekave online ndërkombëtare duke përbushur nevojat e studentëve. Gjithashtu studentët kanë mundësinë të aksesojnë biblioteka online. Materialet gjenden lehtësisht si fizikisht dhe elektronikisht,</p> <p><i>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</i></p> <p><i>Dok. 67. Rregullore e Bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka në KUB është në dispozicion të studentëve, për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit (gjatë gjithë javës në orarin 8:30 deri 19:30 dhe të shtunën nga 08:30 në 13:30. Salla është komode dhe me kushte të përshtatshme për të punuar në ambientet e saj. Gjithashtu Shërbimi i informacionit elektronik (me e-mail/katalog elektronik) ofrohet në orarin 8:00-20:00, nga e hëna në të dielë.</p> <p><i>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</i></p> <p><i>Minutat e takimit</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit),</p>	<p>Nga takimet, vizitat, që GVJ zhvilloi në institucion, vërehet një frymë bashkupunimi mes departamenteve e bibliotekës për rritjen e cilësisë së shërbimit të bibliotekës. Lektorët e lëndëve të programit të studimit depozitojnë gjithmonë në bibliotekë një kopje të materialeve të leksioneve, nëse nuk ka libra si fond fizik. Studentët dhe personeli akademik kanë akses në të gjitha fondet online.</p>

<p>përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Me kërkesën dhe në bashkëpunim me departamentet parashikohen blerjet e reja të titujve të librave duke pasuruar vit pas viti në fondin e saj. Sot gjendja e bibliotekës është 7150 tituj në gjuhë shqipe dhe të huaj, në formatin letër. Biblioteka në funksion të azhurnimit të stafit akademik dhe studentëve mbi listën e hyrjeve të reja, listën e abonimeve vjetore. GVJ konstaton përpjekje të institucionit për pasurimin e bibliotekës dhe plotësimin e kërkesave të stafit akademik me libra. Është synuar që literatura bazë të jetë e disponueshme në fondin fizik Vëmendje e veçantë i është kushtuar aksesit në bibliotekat online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelit akademik në një literaturë të përditësuar.</p> <p><i>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</i> <i>Dok 67.1 Relacion i bibliotekës KUB</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Literatura bazë e programit të studimit është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme janë kryesisht në gjuhë të huaj.</i> - <i>Biblioteka është në dispozicion të studentëve të programit të studimit gjatë gjithë javës në orarin 8:30 deri 19:30 dhe të shtunën nga 08:30 në 13:30.</i> - <i>Është siguruar akses në biblioteka online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelit akademik në një literaturë të përditësuar.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të</p>	<p>KUB disponon dhe administron informacionin e duhur për studentët, stafin akademik dhe personelin administrativ përmes</p>




<p>menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>një sistem menaxhimi i mirëpërcaktuar në procedura sipas rregullores së institucionit dhe rregulloreve të brendshme të strukturave në funksion të tij. Konkretisht GVJ konstaton në këtë drejtim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sekretarinë mësimore e cila është përgjegjëse për administrimin e informacionit dhe pasqyrimin e tij në regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike të cilat mbahen në forme elektronike dhe në hard copy. - KUB ka krijuar një portal që lejon administratën, pedagogët dhe studentët të komunikojnë dhe ku studentët mund të gjejnë gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me provimet, oraret mësimore, aktivitetet, pedagogët; Aksesin në portal mundësohet nëpërmjet faqes web https://portal.kub.edu.al/hyrje/, ku ofrohet hyrja dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Ndërkohë po punohet për përmirësimin e sistemit të integruar dhe digjitalizuar të informacionit në shërbim të sekretarisë mësimore, studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ. Në planin strategjik të KUB është edhe investimi në informatizimin e sistemit të menaxhimit të të dhënave. - Google for Education ka qenë edhe paketa e përdorur nga stafi akademik për procesin mësimor gjatë situatës së Covid-19 ku moduli i komunikimit online Google Classroom është përdorur për arritjen e një komunikimi interaktiv student - pedagog. <p><i>Dok. 46. Rregullore e Sekretarisë Mësimore, kreu II;</i> <i>Dok. 33.6. Regjistri i të dhënave të studentëve/AMZA;</i> <i>Dok 33.7 Regjister i rezultateve , performances se studimit</i> <i>Dok. 62. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme</i> <i>Dok. 62.1. Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB;</i> <i>Dok. 62.2. Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB</i></p>
--	---

	<p><i>Dok. 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "I Biznesit" 2021-2026</i></p> <p><i>Vizita GVJ në institucion</i></p> <p><i>Raporti i Vleresimit të Brendshëm Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>KUB garanton përmes strukturave administrative të ngritura administrimn e informacionit në lidhje me personelin akademik, studentët dhe progresin e programit mësimor. Statuti dhe rregulloret e brendshme përcaktojnë qartë detyrat në lidhje me funksionimin e strukturave të cilat janë përgjegjëse për mbajtjen dhe menaxhimin e dokumentacionit për programin e studimit. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore ruhen dhe administrohen informacione për personelit akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Protokollit janë përgjegjëse për dokumentacionin e personelit akademik (PAE/PAK), stafit administrativ. Sekretaria Mësimore, e cila sipas ligjit, udhëzimeve e rregulloreve të dedikuara për gjithçka lidhet me dokumentimin dhe administrimin e veprimtarisë mësimore.</p> <p><i>Dok. 1. Statuti i KUB</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit"</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Midis studentëve dhe personelit akademik ekziston një komunikim interaktiv, si fizik, student-staf akademik gjatë orës së mësimi, ashtu edhe jashtë saj. Portali i KUB siguron module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit. Personeli ka informacion për studentët sipas profileve dhe degëve të studimit, për çdo modul ku është i aktivizuar. Në përfundim të zhvillimit të modulit ruhen rezultatet e secilit student dhe ky informacion i komunikohet çdo studenti në profilet përkatëse. Institucioni përdor edhe faqen online institucionale të KUB lidhur me informacione të detajuara për njoftime të ndryshme lidhur me aktivitete që zhvillohen, mobilitete në kuadër të programeve europiane, tarifa të studimit, informacione të detajuara lidhur me strukturën e vitit akademik dhe të dhëna për fakultetin etj.</p>

	<p><i>Dok. 62. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme</i></p> <p><i>Dok. 62.1. Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB;</i></p> <p><i>Dok. 62.2. Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB</i></p> <p>https://kub.edu.al/</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron adresa personale uniforme me domain të institucionit dhe llogari me akses elektronik personal. Gjithashtu, në dispozicion është portali KUB, faqa zyrtare e KUB ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë.</p> <p><i>Dok. 62. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme</i></p> <p><i>Dok. 62.1. Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB;</i></p> <p><i>Dok. 62.2. Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB</i></p> <p>https://kub.edu.al/</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit të KUB gjendet informacion për KUB, programet e studimit, partnerët, aktivitetet e ndryshme. Informacioni i detajuar për programin dhe personelin akademik mund të aksesohet nëpërmjet portalit të KUB ku aksesimi për të interesuarit ofrohet me kërkesë ndaj institucionit. Gjithashtu në KUB, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, e cila udhëhiqet nga profesor dhe staf i kualifikuar, njih të interesuarit me programet, përfitimet, punën dhe perspektivat në të ardhmen. Përveç kësaj zyre dhe zyra e pranimeve njih të interesuarit dhe ju jep të gjithë informacionin e nevojshëm për programin e studimit, kushtet, dokumentet, tarifat, etj. Informacioni në faqen web ofrohet në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.</p> <p>https://kub.edu.al/</p> <p><i>Raporti i Vleresimit të Brendshëm Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike</i></p>

	https://kub.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/Guida-Studentore-2020-2021.pdf			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - KUB disponon portalin KUB, që bën edhe monitorimin e aktivitetit akademik për programin e studimit. - Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre administrohet nga Sekretaria Mësimore dhe zyra e Burimeve Njerëzore. - Studentëve dhe stafit akademik u mundësohet hyrje e dedikuar në portalin KUB nëpërmjet emrit të përdoruesit/emailit dhe fjalëkalimit të personalizuar - Informacioni i detajuar për programin dhe personelin akademik mund të aksesohet nëpërmjet portalit të KUB, Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, dhe zyrës së pranimeve njih të interesuarit dhe ju jep të gjithë informacionin e nevojshëm për programin e studimit, kushtet, dokumentet, tarifat, etj. - Informacionet publikohen në dy gjuhë në faqen zyrtare të KUB shqip dhe anglisht. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e	KUB harton raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar. Në to raportohet gjithashtu për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i aspekteve financiare në nivel

<p>studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>institucioni mbulohet nga Administratori i KUB dhe Bordi i Administrimit duke siguruar edhe komunikimin me Senatin akademik. Raportet financiare nuk detajohen në nivel programi studimi ndaj nuk është i mundur vlerësimi më i detajuar i kostove të programit të studimit. Megjithatë, duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme të KUB, GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për më tepër se një cikël të plotë studimi.</p> <p><i>Dok. 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022;</i></p> <p><i>Dok 39.1 Relacion per realizimin e buxhetit 2022 dhe planifikimin 2023 FE.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstaton se në raportimin e dërguar nga KUB janë të pasqyruara në nivel institucioni plani dhe realizimi i financimeve për burimet njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet për aktivitetin kërkimor shkencor, shpenzime materiale, investime infrastrukturore dhe materiale, detyrimet financiare, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet, shërbimet trajnuese dhe zëra të tjerë. Gjithashtu në kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit gjendet informacion për financimin që KUB ka realizuar në funksion të aksesit në bibliotekat online. Sipas raportit vjetor të veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB 2021-2022 në vitin 2022 buxheti për bibliotekat parashikonte si burime financiare të nevojshme rreth 300 mijë lekë, për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj të autorëve kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Dok. 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022;</i></p> <p><i>Dok 39.1 Relacion per realizimin e buxhetit 2022 dhe</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson</p>	<p>Analiza financiare dhe realizimi i zërave të investimit dhe shpenzimet është subjekt i kontroleve periodike nga</p>

<p>dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Administratori i institucionit dhe Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar. Institucioni i nënshtrohet në mënyrë periodike auditimit të brendshëm organizuar nga strukturat përkatëse në varësi të drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit të KUB dhe auditimit të jashtëm ushtruar nga strukturat shtetërore financiare dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Auditimi i jashtëm i Pasqyrave Financiare të KUB, prej disa vitesh kryhet nga Kompania Ndërkombëtare të Auditimit “Grant Thornton”. Sipas RVB, gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, paraqiten për diskutim dhe vendimmarrje në organet drejtuese të KUB, në Senatën Akademik, apo në Bordin e Administrimit.</p> <p><i>Dok.1 Statuti KUB</i></p> <p><i>Dok 39.3 Raport Grant Thornton mbi certifikaten e pasqyrave financiare vjetore,2022</i></p> <p><i>Dok. 30.9. Marrëveshje bashkëpunimi KUB-Grant Thornton</i> https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/</p> <p><i>Raporti i Vleresimit te Brendshem Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Informacioni i pasqyruar, mbi realizimin e buxhetit të miratuar, në faqen web të KUB është në nivel Kolegji.</p> <p>https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe</p>	<p>GVJ konstaton se nga të dhënat e publikuara në faqen e KUB në dokumentat e raporteve financiare për të ardhurat dhe finacimet për tre vitet e fundit, institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e veprimtarisë së tij akademike dhe ecurinë normale të programeve të studimit. Shpenzimet në KUB nuk i kalojnë të ardhurat e realizuara.</p> <p>https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/</p> <p><i>Dok. 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022;</i></p>




diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.				
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - KUB rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare për të realizuar objektivat e tij lidhur me programin e studimit. - Pjesa më e madhe e financimit vjen nga të ardhurat e studentëve, ndaj duhen bërë përpjekje për rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim dhe kontratat. - Nuk ka një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit. <p>Nisur nga situata financiare e përgjithshme e KUB, GVJ mendon se institucioni garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit për më tepër se një cikël të plotë studimi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin	Pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi mbështetet në Statutin e KUB, Rregulloren e KUB, Rregulloren e FE, Rregulloren e DEP dhe

<p>e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Rregulloren e programit të studimit. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e FE zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</p> <p><i>Dok. 1 Statuti KUB</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit"</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e ndjekura nga FE janë të mirëpërcaktuara në rregulloret e ndryshme të të gjithë elementëve që lidhen që me pranimin në këtë program studimi, ndjekjen e procesit mësimor, vlerësimin e studentit e deri në diplomim. Procedurat e ndjekura janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës dhe drejtohet e kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese përkatëse me kompetenca të përcaktuara në rregulloret përkatëse.</p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit"</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e</p>	<p>Përcaktimi i kriterëve pranuese në programin Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" kalon për miratim në të gjitha njësitë përgjegjëse për</p>




kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.

këtë program studimi (DEI, FE, Rektorat, Senat akademik, MAS) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të KUB. Në kërkesat për kuota të dërguar MAS parashikohet edhe pranimi i kandidatëve të huaj. Për dy vitet e fundit akademike regjistrimet për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informatike" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" kanë qënë si më poshtë:

Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nr. i studentëve të transferuar Viti I	Nr. i studentëve të transferuar Viti II
2021-2022	16	3	-
2022-2023	17	-	1

Kriteret e pranimit shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dok. 25.1. Propozimi i Kuotave në MAS 2022-2023;

Dok. 25.2. Propozimi i Kriteve në MAS 2023-2024;

Dok. 64. Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit të studentëve 2022-2023;

Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI Tabela 21

Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të

Rregulloret e institucionit, njësisë kryesore dhe programit të studimit kanë informacion të plotë për procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Këto informacione, studentët mund ti gjejnë në zyrat përkatëse në institucion dhe në faqen zyrtare të KUB.

Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit"

<p>kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”</i></p> <p>https://kub.edu.al/pranimet/#tarifat-dhe-transferimet</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kërkesat e kriteret për këtë program studimi publikohen në faqen web përpara fillimit të vitit akademik. Referuar takimeve në institucion dhe dosjes së vetëvlerësimit, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera si reklamat televizive, ato radiofonike si edhe informimi në zyrat e shërbimit në institucion, pjesëmarrjen në evente dhe panairë lidhur me fushën e arsimit, publikimin në gazeta dhe revista, flyers, postera, prezantime, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”</p> <p><i>Dok. 63. Guida Studentore KUB Viti Akademik 2023-2024;</i></p> <p><i>Dok. 65. Fletë Palosje Informative për Vitin Akademik 2023-2024;</i></p> <p>https://kub.edu.al/pranimet/#tarifat-dhe-transferimet</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Referuar kuotave të propozuara nga KUB, për vitin akademik 2022-2023, shihet se ndërmjet të tjerave ka dhe 31 kuota për kandidatë me statusin e personit me aftësi të kufizuar dhe 12 kuota për kandidatë të pakicave rome dhe egjiptiane. Kriteret e përcaktuara dhe të publikuara janë për të gjithë kandidatët. GVJ konstaton se institucioni në hartimin dhe zbatimin e kriterëve, ndjek plotësisht në mënyrë rigorozë gjithë hapat e parashikuara në aktet nënligjore në fuqi të nxjerra nga MAS si dhe në përcaktimet dhe hapat ligjore të parashikuara në dokumentet zyrtare të KUB (Statut, Rregullore).</p>

	<p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit"</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. 25.1. Propozimi i Kuotave në MAS 2022-2023;</i></p> <p><i>Dok. 25.2. Propozimi i Kritereve në MAS 2023-2024;</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Referuar kuotave të propozuara nga KUB, për vitin akademik 2022-2023, shihet se ndërmjet të tjerave ka dhe kuota për kandidatë nga republika e Kosovës (26), kandidatë me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut (66), Mali i Zi (4), Presheva (10), Medvegja (10) dhe Bujanovci (10). Kriteret e përcaktuara dhe të publikuara janë për të gjithë kandidatët.</p> <p><i>Dok. 25.1. Propozimi i Kuotave në MAS 2022-2023;</i></p> <p><i>Dok. 25.2. Propozimi i Kritereve në MAS 2023-2024;</i></p> <p>https://kub.edu.al/pranimet/#tarifat-dhe-transferimet</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Referuar takimeve në institucion, dosjes së vetëvlerësimit dhe RVB, KUB aplikon politika për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</p> <p><i>Dok. 49. Listat e miratimit të studentëve të cilët përfitojnë Bursa për Vitin Akademik 2022-2023;</i></p> <p><i>Dok. 64. Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit të studentëve 2022-2023</i></p> <p><i>Takimet në institucion.</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>- FE garanton barazinë dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në programin e studimit.</i></p>

	<p>- Ka një bashkëpunim të mirë ndërmjet hallkave të ndryshme konsultative dhe vendimarrëse në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me pranimin e studentëve.</p> <p>- Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej MAS. Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p>- Në faqen web të KUB publikohen kriteret për kandidatët.</p> <p>- KUB aplikon politikat për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</p> <p>GVJ vlerëson se KUB/FE/DEI kanë hartuar, ndjekin dhe zbatojnë politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studentëve që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Ndër mënyrat për të marrë informacion të plotë, në KUB, në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faqja zyrtare e internetit. - Sekretaria mësimore e cila ju jep informacion të detajuar studentëve për lëndët, kreditet, kalimin në vitin e dytë të studimeve. - Java e orientimit të studentët ku ata informohen për programin mësimor, ambjentet, detyrimet dhe të drejtat e studentëve.

	<p>- Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës</p> <p>Burime bazë të informimit janë rregulloret e institucionit (Rregullorja e KUB, Rregullorja e FE, Rregullorja e DEI) si dhe Rregullorja e programit të studimit. Në to jepen elementë të tillë si pranimi në programin e studimit, pezullimi i studimeve, mobiliteti studentor, viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies, organizimi i semestrave mësimor, organizimi i grupeve mësimore, procesi i regjistrimit për frekuentimin e kursit, frekuentimi i orëve mësimore, kontrolli i dijeve, zhvillimi i provimeve gjatë semestrit, organizimi i sezoneve të riprovimeve, rregullat e provimit, ankimimi i provimeve, organizimi i kurseve intensive (për ndjekjen me frekuentim intensiv 2-3 javor të lëndëve të caktuara), përmirësimi i notës, mbrojtja e diplomës, organizimi dhe vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës etj.</p> <p><i>Takimi në institucion</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit"</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. 63. Guida Studentore KUB Viti Akademik 2023-2024;</i></p> <p><i>Dok. 65. Fletë Palosje Informative për Vitin Akademik 2023-2024;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve nga studime të mëparshme janë të pasqyruar në rregulloren e FE, rregulloren e DEI, rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren për Njohjen dhe Ekuivalentimin e Studimeve për Transferimet, Programet e dyta, apo edhe kualifikimet e kryera me parë. Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme.</p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit"</i></p>

	<p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p> <p><i>Dok. 48.2. Rregullore për Ekuivalentimin e Studimeve Takimi në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Elementët e detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve si dhe literaturën përkatëse. Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre dhe nëpërmjet rregullores së programit të studimit, të sekretarisë dhe të provimeve.</p> <p><i>Takime në institucion;</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike;</i></p> <p><i>Dok 33 Rreg per zhvillimin e provimeve;</i></p> <p><i>Dok. 46. Rregullore e Sekretarisë Mësimore;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome. KUB ka një paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë. Informimi i studentëve bëhet në hollin e KUB si dhe në hapësirën e sekretarisë së fakultetit në portalin e KUB.</p> <p><i>Dok. 60. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë;.</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit"</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p>

	https://www.facebook.com/photo/?fbid=2688808321363619&set=a.1529558877288575
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentat e dosjes së vetëvlerësimit dhe portalin e KUB, institucioni publikon udhëzues studentore dhe përgatit fletëpalosje në mënyrë periodike. Këta udhëzues informojnë të interesuarit dhe studentët e ardhshëm edhe mbi programet e studimit në KUB. Institucioni merr pjesë në panairët e edukimit të zhvilluara nga MAS si p.sh. Panairi Work & Study. Gjithashtu. KUB organizon në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime & konkurse dhe aktivitete të ndryshme, në të cilat sipas RVB, ftohen edhe të interesuarit për programet e studimit në KUB. Këto aktivitete bëjnë të mundur që të interesuarit dhe studentët e ardhshëm të njihen nga afër me KUB dhe programet e studimit që institucioni ofron.</p> <p><i>Dok. 63. Guida Studentore KUB Viti Akademik 2023-2024;</i> <i>Dok. 65. Fletë Palosje Informative për Vitin Akademik 2023-2024;</i> <i>Dok. 66. Program i panairit Work and Study;</i> <i>Leksione të hapura, link:</i> http://kub.edu.al/?s=Leksione%20te%20hapura <i>Trajnime & Konkurse, link: https://kub.edu.al/instituti-per-studime-dhe-aplikime-ne-biznes/</i> <i>Panairi Work & Study, link: https://kub.edu.al/events/work-study/</i></p>
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>KUB vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimeve, syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programit të studimit.</i> - <i>Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve.</i> - <i>Pedagogët u bëjnë të njohur dhe u vënë në dispozicion studentëve syllabusin e lëndës duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit, mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</i>

	<ul style="list-style-type: none"> - Rrjetet sociale si dhe faqja web e KUB luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. - Burimet bazë të evidentuara të informimit janë rregulloret e institucionit, Rregullorja e KUB. Rregullorja e FE, Rregullorja e DEI si dhe Rregullorja e programit të studimit. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ata janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij që në fillimesë. Një pjesë e informacionit, si orari mësimor, struktura mësimore, data provimesh, konsultime, etj., është i aksesueshëm edhe nëpërmjet portalit të KUB, si dhe nëpërmjet klasave virtuale të krijuara nga pedagogët (Google Classroom). Sekretaria mësimore gjithashtu ofron informacion të përgjithshëm mbi programin e studimit si dhe kurrikulën e programit të studimit, ku pasqyrohet qartë lista e lëndëve, kreditet për çdo lëndë, shpërndarja e tyre sipas semestrave dhe tipologjia (me detyrim ose me zgjedhje).</p> <p><i>Takime në institucion;</i></p> <p><i>Portal KUB, link: https://portal.kub.edu.al/hyrje/</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Portali KUB dhe klasat virtuale të krijuara nga pedagogët (Google Classroom) janë disa nga format me anë të të cilave studentët informohen dhe gjejnë informacion të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Gjithashtu një informacion të plotë për lëndët, studentët e marrin në javën e parë të zhvillimit të çdo moduli përkatës nga pedagogu i lëndës.</p> <p><i>Dok. 62. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme;</i></p> <p><i>Dok 62.2 Guida e studentit per përdorimin e platformes classroom KUB</i></p> <p><i>Takimet në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. Ndër detyrat e kësaj zyre është t'ju ofrojë studentëve edhe leksione të hapura si mund të aplikojnë për punësim, t'ju ofrohen mundësi punësimi dhe rekomandime konkrete për të realizuar intervista punësimi etj. KUB gjithashtu duke i mundësuar studentëve kryerjen e praktikave profesionale, falë bashkëpunimeve dhe partneriteteve që ka me kompanitë dhe organizatat e studiove profesionale sipas programeve të studimit që KUB ofron, zyrat kontabël, studiot e shërbimeve informatike të programimit etj. si dhe sipërmarrjet e mesme dhe të mëdha brenda dhe jashtë vendit, i njeh ata me tregun e punës dhe ofertat e punësimit.</p> <p><i>Dok 50 Rregullore e Zyres se Studentit dhe Keshillimit te Karrieres</i></p> <p><i>Partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar, link:</i> https://kub.edu.al/partneret/</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin</p>	<p>Studentëve të programit të studimit, nëpërmjet faqes zyrtare të KUB, u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të</p>




<p>dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>realizimit të tij. Informacioni për ambientet ku do zhvillohet mësimi janë gjatë gjithë kohës të aksesueshme nga studentët në portalin KUB. Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve për regjistrimet, pagesat, notat etj</p> <p><i>Dok 62.2 Guida e studentit per perdorimin e platformes classroom KUB</i></p> <p><i>https://kub.edu.al/studio-ne-kub/</i></p> <p><i>https://kub.edu.al/kampusi-yne/#infrastruktura</i></p> <p><i>http://kub.edu.al/libraria/</i></p> <p><i>https://kub.edu.al/kampusi-yne/#laboratoret-e-informatikes</i></p> <p><i>https://kub.edu.al/?s=praktika</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit etj nëpërmjet faqes web të institucionit dhe nëpërmjet portalit të KUB, i cili është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë.</p> <p><i>Dok. 62. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme;</i></p> <p><i>Dok 62.2 Guida e studentit per perdorimin e platformes classroom KUB;</i></p> <p><i>Takimet në Institucion;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Studentët e programit të studimit informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</i> - <i>KUB shpërndan informacion edhe nëpërmjet faqes zyrtare web duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë.</i> - <i>Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve.</i> - <i>Një rol të rëndësishëm në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale</i>

	<p>për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan dhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.</p> <p>- Portali KUB, ofron informacion në lidhje me programin e studimit dhe është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Mbajtja e statistikave për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit kryhet nga sekretaria mësimore e FE. Të dhënat përpunohen nga sekretaria mësimore dhe ruhen si në format fizik, regjistrat themeltar, rregjistrat e lëshimit të diplomave ashtu dhe në format elektronik.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Programi i studimit</th> <th>Viti Akademik</th> <th>Numri total i të diplomuarve</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"</td> <td>2022 - 2023</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ zhvilloi edhe një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotësimi i regjistrat themeltar dhe rregjistrat të lëshimit të diplomave janë në përputhje me standardet dhe udhëzimet e MAS.</p> <p><i>Vizitat në institucion</i></p> <p><i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI Tabela 23</i></p>	Programi i studimit	Viti Akademik	Numri total i të diplomuarve	Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"	2022 - 2023	6
Programi i studimit	Viti Akademik	Numri total i të diplomuarve					
Master i Shkencave në "Shkenca Informatike"	2022 - 2023	6					
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e</p>	<p>Të dhënat në lidhje me studentët mbahen në formë elektronike dhe në format letër. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbledhjen e informacionit dhe administrimin e dokumentacionit për çdo student që në momentin e regjistrimit</p>						

<p>studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>të tij deri në përfundim të studimeve. Kjo strukturë administron të dhëna në lidhje me procedurat e transferimit dhe ç'regjistrimet që mund të ketë gjatë vitit akademik. Të dhënat pasqyrohen në rregjistrin themeltar të studentëve, regjistri i gjeneraliteteve dhe notave, dhe regjistrat e lëndëve semestrale.</p> <p>Për dy vitet e fundit akademike regjistrimet për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" kanë qënë si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="614 712 1364 1041"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë</th> <th>Nr. i studentëve të transferuar Viti I</th> <th>Nr. i studentëve të transferuar Viti II</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021-2022</td> <td>16</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>17</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit dhe e gjeti atë në përputhje me standardet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Vizitat në institucion;</i> <i>Dok. 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_MSc_SHI;</i></p>	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nr. i studentëve të transferuar Viti I	Nr. i studentëve të transferuar Viti II	2021-2022	16	3	-	2022-2023	17	-	1
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nr. i studentëve të transferuar Viti I	Nr. i studentëve të transferuar Viti II										
2021-2022	16	3	-										
2022-2023	17	-	1										
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen në format letër, në regjistrat përkatës, si dhe në format elektronik, gjë që bën që ky informacion të jetë lehtësisht i aksesueshëm. KUB po punon për përmirësimin e sistemit të integruar të informacionit në shërbim të sekretarisë mësimore, studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ.</p> <p><i>Dok.1 Statuti KUB;</i></p>												




	<p><i>Raporti i Vleresimit te Brendshem Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike;</i></p> <p><i>Vizitat në institucion;</i></p>						
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e të gjithë dokumentacionit (sekretaritë mësimore, etj.). Veprimtaria e sekretarisë mësimore të KUB dhe asaj të FE mbështetet në rregulloren e KUB, rregulloren e FE dhe rregulloren e Sekretarisë Mësimore. Dokumentacioni që ruhet në sistemin kompjuterik të KUB është nën mbikqyrje të vazhdueshme nga specialistët e IT, duke garantuar menaxhimin e sigurt të informacionit dhe të të dhënave. Kontrolli dhe verifikimi i informacionit është lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar në KUB.</p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit";</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE;</i></p> <p><i>Dok. 46. Rregullore e Sekretarisë Mësimore;</i></p> <p><i>Dok 33.2 Proces verbal verifikimi te dhenash regjister amze , arritje akademike;</i></p> <p><i>Raporti i Vleresimit te Brendshem Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike;</i></p>						
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>DEI/FE/KUB hartojnë raporte analitike vjetore. Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) analizon gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti ashtu dhe instanca të tjera. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel institucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik.</p> <p>Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Nota mesatare në hyrje</td> <td>7</td> <td>7.5</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	2021-2022	2022-2023	Nota mesatare në hyrje	7	7.5
Viti akademik	2021-2022	2022-2023					
Nota mesatare në hyrje	7	7.5					

Të dhënat në lidhje me punësimin e tyre për periudhën 2022-2023

Numri total i të diplomuarve	Të punësuarit në përputhje me diplomën	Të punësuarit jo në përputhje me diplomën	Të papërcaktuar
6	6	-	-

ZSKK mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Ajo mban të informuar, fton dhe orjenton studentët e diplomuar në takime, trajnime dhe aktivitete brenda dhe jashtë institucionit. Gjithashtu, ZSKK çdo vit akademik harton raporte punësimi lidhur me çdo program, duke analizuar shkallën e punësimit, sektorët ku janë të punësuar studentët, institucionet apo bizneset ku janë të punësuar studentët, etj.

<https://kub.edu.al/instituti-per-studime-dhe-aplikime-ne-biznes/>

Dok. 54. Të dhënat e punësimit të Studentëve Alumni në KUB 2022-2023;

Raporti i Vleresimit të Brendshëm Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike; aneks tabelat përmbledhëse (tabelat 21, 23);

Dok. 21.2. Analiza Mësimore Kërkimore DEI 2022-2023;

Konkluzione

GVJ konstaton se:

- Sekretaria mësimore e FE mban statistika për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat përpunohen dhe ruhen si në format fizik, regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave, ashtu dhe në format elektronik.
- Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.
- Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa ZSKK analizon gjendjen e punësimit të studentëve.

	<i>GVJ vlerëson se KUB/FE dhe DEI mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstatoi se KUB ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Këshillat e studentëve (Neni 73 në Statutin e KUB) janë organizime të pavarura të studentëve të KUB-së, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve të KUB-së në të gjitha programet e studimit. Këshilli studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Në anëtarët e Senatit Akademik përfshihen dhe përfaqësues të studentëve, duke mundësuar në këtë mënyrë transmetimin e zërit të tyre në këtë organ drejtues si dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. (Neni 17 në Statutin e KUB). Sipas RVB , në senat përfshihet një student. <i>Dok. 1. Statuti i KUB, neni 17 pika 2; neni 23 pika 2; 73 pika 5;</i>

	<i>Raporti i Vleresimit te Brendshem Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike;</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>KUB/FE kanë garantuar përfshirjen e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse, këshillat, etj. Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. Sipas rregulloreve të KUB dhe FE studentët shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë. Nga takimet në institucion me studentët, këto pyetësorë realizohen përpara provimeve dhe janë anonime duke shprehur mendimin real të tyre. KUB angazhon edhe entitete të pavarura, si IQE (Instituti për Cilësi në Edukim), për të realizuar pyetësorë dhe për të bërë vlerësimin e procesit mësimor, vetë KUB-it dhe cilësinë e shërbimit të stafit akademik.</p> <p><i>Dok. 1. Statuti i KUB;</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit";</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FE;</i></p> <p><i>Dok 45.1 Raporti i IQE per student , 2023;</i></p> <p><i>Dok 44 Raporti i IQE per Staf Akademik 2021;</i></p> <p><i>Dok. 41. Raporti i NjSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023;</i></p> <p><i>Dok. 43.3 Format Pyetësori i Studentëve KUB;</i></p> <p><i>Dok. 43.5. Vendim i SA për miratimin e planit të punës për realizimin e rekomandimeve të IQE 2021;</i></p>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament,	<p>Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të KUB bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët tërhiqet, ndërmjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Përpunimi i të dhënave të këtij pyetësori për çdo program studimi, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Megjithatë, referuar dokumentacionit të paraqitur, nuk ka patur përmirësime në kurrikulën e programit të studimit në tre vitet e fundit. GVJ gjatë</p>

<p>me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>takimeve në institucion u informua se elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar kryesisht në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve.</p> <p><i>Dok. 1. Statuti i KUB;</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit";</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE</i></p> <p><i>Dok 45.1 Raporti i IQE per student , 2023;</i></p> <p><i>Dok 44 Raporti i IQE per Staf Akademik 2021;</i></p> <p><i>Dok. 41. Raporti i NjSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023;</i></p> <p><i>Dok. 43.3. Format Pyetësori i Studentëve KUB;</i></p> <p><i>ok. 43.5. Vendim i SA për miratimin e planit të punës për realizimin e rekomandimeve të IQE 2021;</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në rregulloret e KUB, FE dhe Programit të Studimit janë të përcaktuar qartë mënyra e vlerësimit të studentëve për vlerësimin përfundimtar duke ju mundësuar dhënien e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në FE/KUB vlerësimi përfundimtar i çdo kursi kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit duke filluar nga vlerësimi i vazhduar, gjatë semestrit, ku studenti vlerësohet deri me 40% të pikëve, lidhur me frekuentimin, aktivizimin, testin ndërmjetës dhe detyra kursi. Ndërkohë që për provimin përfundimtar studenti do të vlerësohet deri me 60% të pikëve. Në Rregulloren e Programit të Studimit janë përcaktuar edhe rregullat e komunikimit të rezultetit të provimit me ID e çdo studenti, ose me email-in personal të tyre, si dhe në nenin 16 përcaktohen rregullat për ankimimin e rezultetit. Në rregulloren për Procedurat e Zhvillimit të Provimeve përcaktohet se studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim sekretarisë jo më vonë se 3 ditë kalendrike nga dita e publikimit të rezultateve dhe trajtimi i ankesës kryhet sipas një procedure të mirëpërcaktuar në rregullore e cila shkon deri në një shikim eventual të tezës së provimit nëpërmjet një komisioni ad-hoc.</p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit";</i></p>




	<p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE;</i></p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike";</i></p> <p><i>Dok 33 Rregullore per zhvillimin e provimeve</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>KUB garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</i> - <i>Studentët në KUB janë të organizuar në Këshilla Studentore duke mundësuar shprehjen e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit.</i> - <i>Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të KUB si dhe përpunimi i pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit</i> - <i>Elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar kryesisht në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve.</i> - <i>Vlerësimi i kontrollit të dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave e përcaktuara në rregulloret përkatëse të cilat garantojnë barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit. Studentëve u njihet e drejta e ankimit.</i> <p><i>GVJ vlerëson se KUB/FE/DEI përfshijnë dhe angazhojnë studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Gjithashtu studentët përfshihen në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në KUB funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) - Sekretaria Mësimore <p>ZSKK u ofron studentëve informacion dhe këshillim sipas kërkesave të tyre. Ndër shërbimet që u ofrohen studentëve nga kjo zyrë janë trajnimet, intervistat për mundësi punësimi, këshillime etj.</p> <p>Sekretaria mësimore e FE-së është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel fakulteti dhe ka për mision funksionimin, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit në KUB studentit i ofrohet informacion lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - procesin mësimor - procesin e provimeve - procesin e vlerësimit - vërtetime të ndryshme - listë notash - evente, aktivitete, konferenca, leksione të hapura, aktivitete sportive e artistike, udhëtime etj. <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit";</i></p> <p><i>Dok. 50. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierrë;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin</p>	<p>Përveç Sekretarisë Mësimore e cila disponon dhe vë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me regjistrimin dhe avancimin akademik të studentëve, për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të tyre dhe asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, një rol të veçantë në informimin e studentëve luan dhe faqja zyrtare e KUB dhe Portali i KUB.</p>

<p>mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit";</i> <i>Dok 46 Rregullore e sekretarise mesimore;</i> <i>Dok 33 Rregullore per zhvillimin e provimeve</i> <i>Dok. 62. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme;</i> <i>Dok. 62.1. Guida për përdorimin e platformës classroom_KUB;</i> <i>Dok. 62.2. Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit/Rrjetin Alumni, dhe krijon mundësi punësimi për studentët/ alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e dhe jep informacion dhe orientim për praktikën profesionale. Përveçse nga ZSKK, studentët informohen edhe nga sekretaria mësimore, por edhe nga stafi akademik mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programet e studimit, - Akreditimin e tyre, - Organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve, - Kryerjen e praktikës, - Për zgjedhjen e temës së diplomës dhe udhëheqësit përkatës për diplomën etj. <p><i>Dok. 50. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës;</i> <i>Dok. 46. Rregullore e Sekretarisë Mësimore;</i> <i>Dok 55 Udhëzues per pergatitjen e Praktikes Profesionale</i> <i>Urdher per caktimin e pedagogut per ndjekjen e praktikave</i> <i>Dok. 68. Urdhër dekani për ndjekjen e praktikave mësimore</i> <i>Takime në Institucion;</i></p>




	<i>Raporti i Vleresimit te Brendshem Programi Master i Shkencave Shkenca Informatike;</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) mban të dhëna për punësimet pas diplomimit. Gjithashtu ky sektor është struktura përgjegjëse që harton dhe raporton periodikisht në MASR të dhëna statistikore. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) mundëson:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informimin e studentëve për mundësitë e punësimit (nëpërmjet postës elektronike si dhe nëpërmjet zhvillimit të takimeve informuese) - Zhvillimin e trajnimeve - Mbatjen e kontakteve me studentët e diplomuar - Krijimin dhe përditësimin e të dhënave për punësimin e studentëve - Hartimin e raporteve dhe statistikave dhe vënien në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. <p><i>Dok. 50. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës;</i></p> <p><i>Dok. 54. Të dhënat e punësimit të Studentëve/Alumni në KUB 2022-2023;</i></p> <p><i>Takime në Institucion</i></p>
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në KUB funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), Sekretaria Mësimore njësi të cilat janë shumë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. - Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit/Rrjetin Alumni dhe krijon mundësi punësimi për studentët/ alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të

	<p><i>dhëna statistikore, orienton studentët për praktikat profesionale etj.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson se KUB ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave. Këto njësi e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Zyra e karrierës i ndjek studentët pas diplomimit, mban të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe informon organet e autoritetet drejtuese/ose politikëbërese.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	FE e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standardet e vendosura nga KUB dhe ato shtetërore të cilësisë, duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online). Gjithashtu, për të rritur kapacitetet didaktike të stafit akademik, KUB përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies përdorimin e shërbimit Google for Education.

	<p><u>Takimi në institucion;</u></p> <p><i>Dok 62 Udhezues ne nivel institucioni per zhvillimin dhe perdorimin e metodave te ndryshme;</i></p> <p><i>Dok 62.2 Guida e studentit per perdorimin e platformes classroom KUB;</i></p> <p><i>Dok 62.1 Guida per perdorimin e platformes classroom KUB;</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>DEI është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” dhe përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo detyrë drejtohet nga Përgjegjësi i DEI. Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik drejtohet nga NjsBC. GVJ u informua se vlerësimi i lektorëve nga studentët realizohet 2 herë në vit. Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit dhe Dekanati. Ndërsa në fund të vitit raportohet sërish analiza mësimore e cila integrohet në analizën mësimore kërkimore të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore.</p> <p><i>Dok.21.2 Analiza mesimore kerkimore DEI 22.23;</i></p> <p><i>Takime në Institucion;</i></p> <p><i>Dok. 14. Rregullore e zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”. Ky pyetësor plotësohet në fund të çdo semestri. Pyetësori është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC. Garantimi i ankimit të rezultatit të provimit bazohet në procedurën e përcaktuar në rregullore. KUB përveç angazhimit dhe raporteve periodike të NjsBC, angazhon edhe</p>

	<p>agjenci të jashtme të pavarura, si IQE (Instituti për Cilësi në Arsim), për të realizuar pyetësorë dhe raportet përkatëse për studentët dhe stafin akademik.</p> <p><i>Takime në Institucion;</i></p> <p><i>Dok. 14. Rregullore e zyrës së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i></p> <p><i>Dok. 41. Raporti i NjsBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023;</i></p> <p><i>Dok. 45.1 Raporti i IQE për student, 2023;</i></p> <p><i>Dok. 44. Raporti i IQE për Staf Akademik, 2021</i></p> <p><i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE;</i></p> <p><i>Dok 43.3 Format pyetesori i studenteve KUB;</i></p> <p><i>Dok. 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Çdo anëtar i personelit akademik informohet me anë të postës elektronike në lidhje me rezultatet e tij për këtë anketim. Rezultatet e anketimit i dërgohen të grupuara sipas njësive përkatëse edhe drejtuesve të njësive bazë dhe njësive kryesore. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelin akademik, përgjegjësit e njësive bazë analizojnë rezultatet e ankimimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuara për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Publikimi i raporteve të analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies kryhet nga ana e NJSBC, duke i vënë kështu rezultatet e vlerësimit në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara.</p> <p><i>Dok. 41. Raporti i NjsBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Dok 43 Format pyetesori i studenteve KUB;</i></p> <p><i>Dok.21.2 Analiza mesimore kerkimore DEI 2022.2023;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj</p>	<p>NJSBC luan një rol të rëndësishëm në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Ajo njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit</p>




të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	për rezultatet përfundimtare. Rezultatet e përpunuara publikohen dhe në faqen web të KUB. <i>Dok. 41. Raporti i NjsBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023</i> https://kub.edu.al/wp-content/uploads/2023/04/NJSBC.pdf			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>FE e zhvillon programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" në përputhje me standardet e vendosura nga KUB dhe ato shtetërore të cilësisë.</i> - <i>NjsBC drejton në nivel institucioni punën për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</i> - <i>Pyetësorët e vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" mundësojnë garantimin e përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve.</i> <p><i>NJSBC publikon raporte të analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje	Strukturat përgjegjëse, në nivel institucional, për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në KUB është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të cilësisë në nivel institucional jepen në Statut (neni 81, 82, 83 dhe 84). Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë së Sigurimit të

<p>me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përcaktohen në rregulloren e saj. GVJ konstaton se këto struktura janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p><i>Dok. 1. Statuti i KUB;</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit";</i></p> <p><i>Dok. 14. Rregullore e zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në nivel institucional, NJSBC, përbëhet nga 5 anëtarë (3 anëtarë janë përfaqësues të fakulteteve respektive, 1 anëtar është ekspert i jashtëm si dhe 1 anëtar student). NJSBC monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikëqyr proceset e vlerësimit të brendshëm dhe raportimin në rastet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë etj. Ajo në themel të punës së saj ka zbatimin e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Takime në institucion.</i></p> <p><i>Dok. 1. Statuti i KUB;</i></p> <p><i>Dok. 14. Rregullore e zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Akreditimi i jashtëm kryhet periodikisht në KUB. Institucionit i është dhënë një vlerësim pozitiv për cilësinë akademike me një kohëzgjatje prej 4 vitesh, me Vendimin Nr.03, datë 07.01.2022, të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Me Vendim Nr.100 Dt. 10.11.2017 është bërë riakreditimi institucional i KUB. Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion", me qëllim akreditimin e tij, po realizohet për herë të parë nga ASCAL.</p> <p><i>Dok 18.1 Certifikate Akreditimi KUB;</i></p> <p><i>Dok. 18. Urdhër Akreditimi Institucional KUB;</i></p>




	<i>Dok.18.2 Vendim Nr.100 Dt. 10.11.2017 dhe vitit 2022 te BA per riakreditimin institucional te KUB.;</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	<p>Në mënyrë periodike, NJSBC zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin të stafit akademik nga studentët. - Vlerësimin të lëndës. - Vlerësimin të kënaqësisë së studentëve nga institucioni. - Pyetësorë me stafin akademik dhe atë administrativ mbi vlerësimin e kënaqësisë së tyre ndaj Institucionit. <p>NJSBC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë mes gjithë aktorëve të brendshëm të tij.</p> <p><i>Dok. 41. Raporti i NjsBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Dok 43 Format pyetesori i studenteve KUB;</i></p> <p><i>Dok.21.2 Analiza mesimore kerkimore DEI 22.23;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në KUB, Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, garantohet nëpërmjet strukturave të ngritura në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. - NJSBC funksionon në nivel institucioni, në KUB. - NJSBC monitoron cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikëqyr proceset e vlerësimin të brendshëm, raportimin në rastet e vlerësimin të jashtëm të cilësisë etj. - Në mënyrë periodike, NJSBC zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin. <p><i>NJSBC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Mbikëqyrja periodike e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” bazohet në marrjen e informacionit nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen në fund të çdo semestri përpara zhvillimit të provimit përfundimtar. Pyetësorët i kushtohen vlerësimit të lëndëve të programit të studimit dhe personelit akademik. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës shqyrton veprimtarinë mësimore duke kryer analiza vjetore të realizimit të procesit mësimor, punës administrative dhe asaj kërkimore shkencore në të cilat shqyrtohen problematikat e hasura dhe hapat konkrete në drejtim të përmirësimit. Të gjitha udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore ndiqen dhe zbatohen.</p> <p><i>Dok. 41. Raporti i NjSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Dok 43 Format pyetesori i studenteve KUB;</i></p> <p><i>Dok.21.2 Analiza mesimore kerkimore DEI 22.23</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga</p>	<p>Raportet e vetëvlerësimit hartohen në nivel institucioni. Në to jepet një tablo e rezultateve të vlerësimit për vitin përkatës akademik. Pjesë e raportimeve janë edhe rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat që duhet të merren për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë në programin e studimit apo aspekteve të tjera që lidhen me të. KUB ka angazhuar edhe ekspertë të jashtëm në kryerjen e pyetësorëve të stafit dhe studentëve.</p> <p><i>Dok. 41. Raporti i NjSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023</i></p>

<p>personeli akademik dhe studentët.</p>	<p><i>Dok.21.2 Analiza mesimore kerkimore DEI 22.23;</i></p> <p><i>Dok 45.1 Raporti i IQE per student , 2023</i></p> <p><i>Dok 41 Raporti NJSBC per rezultatet e pyetesoreve ne vitin akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Dok 41.1 Plani i aktiviteve per permbushje te rezultateve te pyetesoreve ne kuader te permiresimit te standarteve te cilesise ne KUB</i></p> <p><i>Dok 44 Raporti i IQE per Staf Akademik 2021;</i></p> <p><i>Dok. 43.5. Vendim i SA per miratimin e planit te punës për realizimin e rekomandimeve të IQE 2021;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në KUB përdoren mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit. Monitorimi i realizimit me korrektësi të programit studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga NJSBC. Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, NJSBC kryen kontrole 2 herë në semestër për të vlerësuar kualifikimin dhe kompetencën e stafit të përfshirë në mësimdhënie dhe merr në mënyrë të rastësishme provime për të kontrolluar cilësinë e korrigjimit të provimit dhe përgatitjes së tezës.</p> <p><i>Dok. 41.2. Raport mbi kontrollin për procesin mësimor;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e</p>	<p>Studentët në KUB janë pjesëmarrës aktivë në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”. Mendimi i tyre merret nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Këshillit Studentor.

<p>intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - përfshirjes në procesin e vlerësimit të programeve të studimeve (pjesë e GVB). - këshillimit me stafin akademik dhe përgjegjësen e departamentit si edhe përdorimit të zyrave mbështetëse për këtë qëllim. - Përfaqësuesit të studentëve në NJSBC. - Pjesëmarrjes në Senatin Akademik. - Pjesëmarrjes në Këshillin e Etikës. <p>Në procesin e vlerësimit kontribuojnë zhvillimi i anketimeve nëpërmjet pyetësoreve të studentëve, mbledhjes së të dhënave nga sekretaria mësimore në lidhje me rezultatet e provimeve, kalueshmërinë, notën mesatare etj., gjurmimit të studentëve të diplomuar, etj. Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të tërthorta të vlerësimit në institucion.</p> <p><i>Dok.1 Statuti KUB</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit";</i></p> <p><i>Dok. 14. Rregullore e zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i></p> <p><i>Dok.11 Rregullore e Keshillit te Etikes</i></p> <p><i>Dok. 17. Urdhër rektori për ngritjen e GVB për akreditimin e parë të programit të studimit MSc në KUB;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në KUB ndiqen dhe zbatohen të gjithë udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore për mbikëqyrjen periodike të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion". - Raportet e vetëvlerësimit, në të cilët jepet një tablo e rezultateve të vlerësimit për vitin përkatës akademik hartohen në nivel institucioni. - Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta të vlerësimit në institucion.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në KUB, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBC, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, në planin strategjik të institucionit synohet dhe bashkëpunimi arsimor ndërkombëtar dhe rritja e cilësisë së stafit. Këto objektiva strategjike do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” dhe në një përshtatje më të mirë e të vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Dok.1 Statuti KUB</i></p> <p><i>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”;</i></p> <p><i>Dok. 14. Rregullore e zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i></p> <p><i>Dok. 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2021-2026;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në</p>	<p>Rregullore e Zyrës së NJSBC përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Rregullorja synon, përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit</p>

<p>sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>shkencor, duke përmbushur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë KUB, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë.</p> <p><i>Dok. 14. Rregullore e zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Një proces gjithëpërfshirës në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informatiçi” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”, I garanton ato. Nga takimet në institucion, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit. Në përmirësimin e cilësisë së programit një rol të rëndësishëm luajnë dhe pyetësorët e studentëve si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme konsultative e vendimmarrëse.</p> <p><i>Dok. 41. Raporti i NJSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Dok.21.2 Analiza mesimore kerkimore DEI 22.23;</i></p> <p><i>Dok 45.1 Raporti i IQE per student , 2023</i></p> <p><i>Dok 41 Raporti NJSBC per rezultatet e pyetesoreve ne vitin akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Dok 41.1 Plani i aktiviteteve per permbushje te rezultateve te pyetesoreve ne kuader te permiresimit te standarteve te cilesise ne KUB</i></p> <p><i>Dok 44 Raporti i IQE per Staf Akademik 2021;</i></p> <p><i>Dok. 43.5. Vendim i SA për miratimin e planit të punës për realizimin e rekomandimeve të IQE 2021;</i></p> <p><i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset</p>	<p>Në veprimtarinë e saj me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë, NJSBC mbështetet edhe nga institucioni, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës.</p>




<p>ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në punën e saj NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti.</p> <p><i>Dok.1 Statuti KUB;</i></p> <p><i>Takime në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me bizneset Për të siguruar vlerësime sa më të besueshme, të pavarura dhe profesionale, KUB në bashkëpunim me NJSBC, ka kontraktuar dhe një kompani të jashtme, Institutin për Cilësi dhe Arsim" (IQE), i cili çdo vit organizon Pyetësin e studentëve dhe stafit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” sa i takon performancës dhe aspekteve të tjera në funksion të saj. Gjithashtu në procesin e përmirësimit të cilësisë së programit të studimit ka ndihmuar dhe pjesëmarrja në Panairin Work and Study dhe organizimi i leksioneve të hapura me të ftuar nga jashtë institucionit.</p> <p><i>Takime në institucion;</i></p> <p>https://kub.edu.al/?s=Leksione%20te%20hapura</p> <p><i>Dok. 30.2. Marrëveshje bashkëpunimi KUB-IQE;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatos se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në KUB, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBC, e cila synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. - Ka një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit. - NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie.

	Në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" kanë kontribuar dhe Panairi i Punës dhe Karrierës e leksione të hapura.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Publikimi i rezultateve të veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Informatike" me profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni" dhe "E-Commerce dhe Inovacion" siguron transparencën e këtyre veprimtarive. Rezultatet e tyre publikohen në trajtën e raporteve dhe vlerësimeve që kanë të bëjnë me institucionin dhe studentët. Në faqen zyrtare web të KUB bëhen publike rezultate të pyetësorëve, Statuti, Rregullorja, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Rektoratit, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë etj.</p> <p><u><i>Dok. 41. Raporti i NjSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023</i></u></p> <p><u>https://kub.edu.al/njsbc</u></p> <p><u>https://kub.edu.al/wp-content/uploads/2022/06/Plani-Strategjik-2021-2026-KUB-1.pdf</u></p> <p><u>https://kub.edu.al/wp-content/uploads/2022/06/Statuti-i-KUB.pdf</u></p>




	<p>https://kub.edu.al/wp-content/uploads/2022/06/Rregullore-Shqip.pdf;</p> <p>https://kub.edu.al/partneret/</p> <p>http://kub.edu.al/?s=Leksione%20te%20hapura</p> <p>http://kub.edu.al/panairi-work-study-3/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Stafi akademik i Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” vihet në dijeni individualisht për pyetëtorin, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. GVJ konstaton se informacioni me rezultatet e vlerësimeve të publikuara në faqen web të institucionit respektojnë lirinë akademike si edhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 dhe ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit.</p> <p><i>Takime në Institucion</i></p> <p>https://kub.edu.al/njsbc</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Pasi procesi i anketimeve me studentët (procesi i sigurimit të cilësisë në përgjithësi) evidenton mangësi dhe dobësi, ai shoqërohet me plan masash konkrete për përmirësimin e tyre. Nëse ka nevojë për mbështetje financiare bashkëpunohet me bizneset.</p> <p><i>Takime në institucion.</i></p> <p><i>Dok 41.1 Plani i aktiviteteve per permbushje te rezultateve te pyetesoreve ne kuader te permiresimit te standarteve te cilesise ne KUB</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në</p>	<p>Nga ana e KUB, GVJ konstaton përpjekje në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion”. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që KUB i jep këtij procesi.</p>

vijim të cilësisë së programit të studimit.	<i>Takime në institucion.</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Hartimi i RVB për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” dhe grumbullimi i informacionit në mbështetje të tij ka qenë një proces në të cilin është angazhuar jo vetëm GVB, por edhe gjithë instancat drejtuese të KUB dhe FE, DEI si dhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Ky proces kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve të programit të studimit për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së tij. Procesi i realizimit të pyetësorëve kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Ndikim pozitiv, në këtë drejtim, ka dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative (Senat, Këshillin e Etikës, Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë së institucionit) në të cilat diskutohen problematika që kanë lidhje me përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><i>Dok. 41. Raporti i NjSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Takime në Institucion</i></p>
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Publikimi i rezultateve të veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” siguron transparencën e këtyre veprimtarive. Transparenca e tyre sigurohet nëpërmjet publikimit të rezultateve në trajtën e raporteve dhe vlerësimeve si dhe nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit të rezultateve të përmbledhura të pyetësorëve, Statutit, Rregullores, Vendimeve të Senatit Akademik, Vendimeve të Rektoratit, Vendimeve të Bordit të Administrimit, etj.</i>

	<p>- <i>Stafi akademik i programit vihet në dijeni individualisht për pyetësorin në lidhje me performancën e tij ndërsa DEI informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. Informacioni me rezultatet e vlerësimeve respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i></p> <p><i>Grumbullimi i informacionit në mbështetje të hartimit të RVB, anketimet me studentët dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative mundësojnë evidentimin e pikave të forta, problematikave, kërcënimeve dhe kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve të programit të studimit për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së tij.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” të ofruar nga “Kolegji Universitar “I Biznesit”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës, organizojnë këtë program studimi me angazhimin e një stafi akademik të ri në moshë dhe të përkushtuar në përcimin e dijeve.
2. Në mbështetje të planit strategjik institucional të KUB, ku përcaktohet si prioritet ndërkombëtarizimi, institucioni ka krijuar bashkëpunime me kompani për krijimin e programeve të praktikës profesionale, zhvillimin e projekteve të përbashkëta dhe sigurimin e mundësive të punësimit për studentët dhe partneritete me institucione akademike dhe kërkimore si shkëmbimin e njohurive, organizimin e konferencave të përbashkëta apo mundësi për studime të avancuara dhe projekte kërkimore.
3. Lëndët në tërësi, plani mësimor dhe organizimi i tij, janë në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimesh dhe i ngjashëm me ato të ofruara nga IAL të tjera.
4. Komunikim student-pedagog, student-institucion shumë efektiv.
5. Studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale sipas statutit dhe rregullores së IAL.
6. Personeli akademik mbështetet financiarisht nga IAL në rritjen e tyre akademike dhe profesionale.
7. Vlerësimi i lëndës është i vazhdueshëm dhe bazohet në frekuentimin, aktivizimin në aktivitetet mësimore dhe detyrat/projektet lëndore.
8. KUB ka funksionale mekanizma të brendshëm dhe të jashtëm të monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë ku përfshihen edhe studentët.

Pika të dobta:

1. Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile, janë pjesërisht në përputhje me elementët e shprehur në VKM nr. 41, datë 24.1.2018 për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë (ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; nr. 185, datë 25.3.2021). *(Standardi II.1, Kriteri 1)*
2. Angazhimi në programin e studimit të stafit akademik me gradën shkencore master. *(Standardi IV.1, Kriteri 1)*
3. Në përmbajtjen e programeve lëndore (syllabuset) për secilën lëndë evidentohen mospërputhje me planin mësimor. *(Standardi II.3, Kriteri 4)*

4. Mungesa e orëve laboratorike të matshme në orë në auditor në secilën lëndë. (*Standardi II.4, Kriteri 1*)
5. Stafi Akademik i Brendshëm nuk mbulon 70% të ngarkesës mësimore në programin e studimit (*Standardi IV.1, Kriteri 2*)

Rekomandime:

1. Të hartohen në nivel njësie bazë raporte analitike vjetore të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit bazuar edhe në rekomandimet e pedagogëve përgjegjës për ndjekjen e praktikave profesionale.
2. Të evitohen përsëritjet e informacionit dhe praktikave në rregulloret të ndryshme institucionale.
3. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të përcaktojë grupin e lëndëve aplikative për të cilat sipas rregullores nuk zbatohet vlerësimi i vazhdueshëm dhe i detyrueshëm 40% ose ta konsiderojë formën e vlerësimit të dijeve si pjesë e lirisë akademike të titullarit të lëndës të përcaktuar në syllabus.
4. Të qartësohet ngarkesa mësimore e veprimtarisë “Praktikë” në planin mësimor dhe të reflektohet në syllabuset e lëndëve;
5. Shtimin e orëve Laboratorike apo/dhe projekte kursi të paktën në lëndët karakterizuese;
6. Të përditësohen syllabuset specifikisht duke: caktuar titullarët e lëndëve sipas ligjit; cilësuar vitin akademik për të cilin syllabusi është miratuar; cilësuar programin e studimit dhe profilin përkatës ku jepet lënda; plotësuar ngarkesën në orë laboratorike në përputhje me planin mësimor;
7. Angazhimin e personelit ndihmës-akademik të dedikuar për mbështetjen e stafit akademik dhe studentëve në zhvillimin dhe realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorëve.
8. Saktësimin e procesit të përshkallëzimit të ankimimit në Rregulloren e KUB dhe në Rregulloren për Zhvillimin e Provimeve.
9. IAL të marrë masa sipas ligjit të angazhojë në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Informatike” me profile “Informatikë Biznesi”, “Teknologji Informacioni” dhe “E-Commerce dhe Inovacion” staf akademik me të paktën gradën shkencore “Doktor”.
10. IAL të marrë masa që stafi akademik i brendshëm të mbulojë 70% të ngarkesës mësimore të programit të studimit.

Evaluation’s conclusions for the first cycle study program Bachelor in “Information Technology” provided by the “University College of Business”




Strengths and affirmations

1. Faculty of Economics and the Department of Economics and Informatics organizes this study program with the engagement of a young and dedicated academic staff committed to sharing knowledge.
2. Based on the University College of Business's institutional strategic plan, where internationalization is defined as a priority, the institution has established collaborations with companies for supporting and enhancing professional practice programs, the development of joint projects and the provision of employment opportunities for students, as well as partnerships with academic and research institutions such as training and teaching mobilities, the organization of joint conferences or opportunities for advanced studies and research projects.
3. The subjects, overall curriculum, and its organization are in line with the formative objectives of the students for this cycle of studies and are similar to those offered by other Higher Education Institutions.
4. Very effective communication between students and faculty, and between students and the institution.
5. Students are represented in the internal decision making entities according to the HEI's statute and regulation.
6. The academic staff is supported financially by the HEI in their academic and professional growth journey.
7. The final assessment of the courses is continuous and is based on attendance, active participation in class activities, tasks/projects and final exam.
8. The University College of Business has functional internal and external mechanisms for continuous quality monitoring and improvement, which include student participation.

Weaknesses

1. The elements that make up the structure of the Bachelor in Information Technology study program are partially in accordance with the elements in VKM no. 41, dated 24.1.2018 for the elements of the study programs offered by higher education institutions (amended by VKM no. 879, dated 18.12.2019; no. 185, dated 25.3.2021). (Standard II.1, Criterion 1)
2. Engagement of some academic staff not in compliance with the law. (Standard IV.1, Criterion 1)
3. The content of the subject programs (syllabi) for each subject reveals inconsistencies with the curriculum. (Standard II.3, Criterion 4)
4. Missing laboratory hours for the courses. (Standard II.4, Criterion 1)
5. The Internal Academic Staff does not cover 70% of the teaching load in the study program. (Standard IV.1, Criterion 2)

Recommendations

1. Prepare a department level annual reports of the benefits from the cooperation agreements based on the recommendations of the staff responsible for the follow-up of internships.
2. Avoid repeating the same information and procedures in several institutional regulations.
3. The department responsible for the study program should determine the courses for which, according to the regulation, the continuous and mandatory 40% assessment is not applied, or the HEI may explicitly consider the form of assessment as part of the academic freedom.
4. Define the teaching load in the curriculum for the "Practice" activity and reflect it in the course syllabuses.
5. Define laboratory hours or/and course projects at least in some of the courses;
6. Update the syllabi by: assigning the course coordinator professors according to the law; define the academic year for which the syllabus was approved; specify the study program and profile where the course is taught; complete laboratory hours in accordance with the curriculum;
7. The engagement of a computer lab technician dedicated to supporting the academic staff and students in the development and implementation of teaching practices and laboratories.
8. Revise the escalation procedure for appeals in the KUB Regulations in accordance with the Regulation for the Development of Exams.
9. The HEI should engage for teaching at master level programs an academic staff with at least a PhD degree.
10. The HEI should take measures in order the internal academic staff to cover 70% of the teaching load of the study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

